

COLLANA DIRETTA DA FRANCESCO ALTIMARI

ALBANICA

2

RACCONTI POPOLARI **di Santa Caterina Albanese**

Raccolti, trascritti e tradotti in italiano
da *P. VINCENZO MALAJ*

Volume edito con il contributo di



Commissione Europea
DG XXII - Progetto BETLA



Università della Calabria
Cattedra di Lingua e Letteratura albanese

Redazione e revisione dei testi
a cura di *Vincenzo Belmonte*

Le foto riportate nel libro sono state gentilmente concesse
dal sig. Stefano Verta di S. Caterina Albanese,
che ringraziamo per la collaborazione.

INDICE

Zogu që këndon nd'mes shpis	3
<i>L'uccello che canta in mezzo alla casa</i>	55
Matria	11
<i>La matrigna</i>	64
Mjeshtëri Franxhisku, prinxhpi uljk e e bilja rregjit	16
<i>Mastro Francesco, il principe lupo e la figlia del re</i>	70
E shkurtura karroc	20
<i>La carrozza corta</i>	74
Kostandini e Fjurëndina	23
<i>Costantino e Fiorentina</i>	77
Vulau e motërza	25
<i>Il fratello e la sorella</i>	79
I shoqi e e shoqja	26
<i>Il marito e la moglie</i>	81
Predhikatori e dhia	27
<i>Il predicatore e la capra</i>	82
Ng'jam nga ki katund	28
<i>Non sono di questo paese</i>	83
Judhçi	29
<i>Il giudice</i>	84
Predhikatori e bishti i djalit	30
<i>Il predicatore e la coda del diavolo</i>	85
Dhia, uljku e ljokrat	31
<i>La capra, il lupo e i cavoli</i>	86
Shën Pjetri e djali	32
<i>San Pietro e il diavolo</i>	87
Monaku i Buzuraks	33
<i>Il monaco di Busuraca</i>	88
Kostandini e Jurëndina	34
<i>Costantino e Jurendina</i>	89

Kostandini i vikërr	36
<i>Costantino il piccolo</i>	91
Vulau, motra e nusja e ljug	38
<i>Il fratello, la sorella e la sposa cattiva</i>	93
Vistër fjaljësh	41
<i>Filastrocca</i>	97
Vistër fjaljësh	42
<i>Filastrocca</i>	98
Fjaljë t'urta	43
<i>Proverbi</i>	99
Gjakegjiza	44
<i>Sanguericotta</i>	100
Dhia me shtat kaciqe	48
<i>La capra con sette capretti</i>	104
Rinuljena e Junuvalji	49
<i>Rinulena e Junuvale</i>	105
Kostandini i vogëljith	51
<i>Costantino il piccolo</i>	107
Fjaljë t'urta	52
<i>Proverbi</i>	109

Albanese

ZOGU ÇË KËNDON ND'MES SHPIS

Një her ishën di vashaz. Ishën di vashaz, di motra, e një vula e... (ahiera ng'ish si është nani, ç'ku vete vete bën drit; ahiera sa t'kishnje një shkarp, kush t'e thot se sa duhej)... e nëng kishën ku t'vejën për shkarpa e van tek malji i rregjit. Alura e para motër tha:

- E, u ngë pata furtun, ma ndëç mua m' duaj ghuardjani i rregjit, u e mirrnja.

Ghuardjani i rregjit gjegji ç'ish nd'ata dushqe, ç'ruaj qet, ruaj animalj, ruaj gjith ata shurbise e ashtu gjegji e rrij qetu. E dita motër tha:

- Ëh, u duanja t' birin e rregjit. Ma u bit kish një shurbes i bukur ç'ju ng'e kini bes: ndëç kishnja di bilj, një ja bënja me nj'iljöz ndë bal e një me nj'palj ari ndë dor.

Pameta gjegji ai ghuardjani. Vate e ja tha rregjit. Rregji kta di vashazit i drëgoi thrritur. Tha:

- Çë that ndë dushk?

- Faregjë!

- Jo, m'e thoni, nj'mos ju pres kriet.

- A, ma ng'mund t'e thomi.

- Jo, ka t'm'e thoni a forca, nj'mos u kumandonj e bit e presnjën kriet.

Qe ç'pat ja thojën. E para tha:

- U e mirrnja ghuardjanin...

E dita ng'do t'ja thoj mëngu, se i nditij turp nga rregji, ma qe kostretu ç'pat ja thoj.

Rregji tha:

- Ëh se bit e mirrni, ti e ti... ti e ti. Però ka t'rrini ashtu si that, se nj'mos ju pres kriet. E qetu!

Qe vërtet ashtu. E para muari kët ghuardjanin e rregjit. E dita muari prinxhpin, t'birin e rregjit. Ma e jëma, e shoqja rregjit, nëng duaj se kish t'mirrij kët vashëz prinxhpi. Ng'e duaj.

- Ti vete e merr nj'vashëz ashtu, nj'vashëz e nëmur?

Ma prinxhpi lu stesu e muari. Ata ishën kutjend e duhshën mir. Dhopu skopjarti ghuerra e ki prinxhpi pat vej ndë ghuerr. Gjith i kish penxëret te kjo e shoqja, përcë e jëma ng'e duaj. Kjo e shoqja e mbajti fjaljën e dhopu nj'cik i bëri kta di bilj me nj'iljöz ndë bal e me nj'palj ari ndë dor. E jëma ng'i duaj, qe senxa koshenxa e i suali ndë muli kta di fanxhulj e i shtu atje. Molonari vate menatet e i gjeti e ja suali t'shoqes.

- Ruaj se ç'fanxhulj t'bukur. Ti pari se i presmi kriet ktire fanxhuljve na nani? Ësht mbëkat, jo?

E shoqja e ktij molonari i rriti kta di fanxhulj me biljt e saj. Lozjën bashk e duhshën mir. Indandu t'shoqen e prinxhpit, kët vashën, t'jëmën e ktire fanxhuljve, e kastjuan, e suterrartën ndutu posht, e mbulitën ndë ghaljinar e i jipjën një thelj buk ditën e një qelq uj ditën. Kta di fanxhulj duhshën mir me t'biljt e molonarit, ma sa u rritën zun sa t'zëhshën me t'vulezrit, çë ng'ishën vulezër daveru, e i thojën t'jatit, molonarit:

- Na ka t'ikmi, na ka t'ikmi, se zëhemi.

- Ma jore! Ju rrita, rrini, rrini!

- Jo, ka t'ikmi. Ti mba biljt tënd, pse na vemi tek furtuna jon.

Alura atire i dha benedhicjonën i jati e iktën. Sa iktën nj'cik, ju përpoq nj'pjakarelj e i tha:

- Ku veni ju, bil, ku veni?

- Ku vemi? Vemi tek furtuna jon, se mëma na diq (përçë ata a dijën se kish dekur e jëma). Mëma na diq e vemi tek na sial era, vemi te kush na jep buk, ëh.

Tha ki pjak:

- Do t'veni daveru tek gjëni buk? Ecni, ecni, ecni shum, ecni nd'at an malji se atje gjëni një pulas me gjith t'mirat mbrënda. Ata ç'gjëni, ulji e hani.

Van e rrëvuan tek ai pulas e daveru gjetën triesën e ndrequr mir e u uljtën e hëngtën.

I biri i rregjit dhopu, si u fërrnua ghuerra, u mbjodh ndë shpit. U mbjodh nga ghuerra ndë shpit e i tha e jëma:

- A, u nga pacia ng'kam se çë t'bënja... Ru ki tratu çë t'bëri jot shoqe: tha se kish t'bëj di bilj t'bukur, një me nj'iljöz ndë bal e një me nj'palj ndë dor, inçe bëri di kuljish... E, nëng është posibile se rri me të...

Ng'folji fare ki, i mjeruami. Nj'dit van a kaça me nj'kumbar. Ture ecur, ture ecur, arrvuan te ki pulas, pa kta di fanxhulj e i tha:

- Ç'bëni ju ktu?

- Ëh, na suali nj'pjakarelj ktu. Na drëgoi nj'pjakarelj e ndodhemi ktu.

- Ëh, ma pero kini gjithsej, ma ju mangon një shurbes.

- Jo, nëng na mangon faregjë - i than rregjit.- Ec, ec ku je e vete, se ng'njohmi mosnjeri.

Vate mbrënda ki prinxhpi e ja tha t'jëmës.

- Oj mo - tha - ng'e dini se nd'at an malji gjeta nj'pulas e ishën di bilj propju si kish t'i bëj ime shoqe, me iljzën ndë bal e paljzën ari ndë dor...

Ajo tha:

- Ec, ec, jot shoqe bëri di kuljish. Ec ku je e vete. Ec ha ndë do t'hash!
Ec fjëj!

Ai gjith i rraxhuar vate sa t'fjëj. E jëma drëgoi at serviturin, atë ç'ljaj
ljugët e ç'bëj t'ngrent, e drëgoi atje, tha:

- Shih se nd'at an malji vate im bir e na bie ndonj zjarr, përçë ki nani o
sonde o menat di se jan t'biljt.

Vate ki servituri, vate t'i arrvoj (alura i vulau i ksaj vashëz u kish nisur,
ng'ish mbrënda) e i tha ksaj vashëz:

- Ru' se çë t'thom: kini gjithsej ktu, ma ju mangon një shurbes.

- Ç'na mangon?

- A, ju mangon ujt e harës.

- Ujt e harës?

- Ëh, ëh, ujt e harës!

- E si ka t'e bëmi sa t'e gjëmi?

- A, - tha - sonde bitë t'gjenj me buz it vula, se ashtu ai niset e vete e
t'e gjën.

U mbjodh mbrënda i vulau e e gjeti me buz t'motrën: qaj. Kish bën
t'ngrent e ng'do t'haj. I tha:

- Ma ç'ke sonde ç'rri ashtu?

- Oj - tha - ru' se si jemi, sa t'mira kemi ç'na drëgoi Zoti Krisht, ma
pero ng'jemi t'mir, se na mangon ujt e harës se sa t'ljahemi.

- A - tha - ti mos mirr fare heljm se u partirinj e t'e gjënj ujt. Sonde ikinj
nga shpia e nëse nesër mbrëma ndë katër ora ng'u mbjodha, ti mbuli
derën, mbuli dritsoret, mbuli se ng'mund u mbjodha.

- Mos ec, mos! - i tha ajo t'vulaut.

- A, a, ti mos m'e kishnje thën, nani ka t'vete.

E vate. Vate e pameta sa arrvoi tek malji, gjeti pameta kët pjakarelj. I
tha:

- Ku vete ti, xhoj?

I rrispundirti ki djalji:

- Ku vete? Vete se... kemi gjith t'mirat, ma pero na mangon ujt e harës
sa t'ljahet ime motër.

- E kush të drëgoi?

- Ime motër. E gjeta me buz t'ime motër e do t'i gjënj ujt, njëmos bin
e merr heljmin.

Alura i tha ki pjaku:

- Vi', vi', ec ati posht se është nj'kruaruq. Atje është nj'pjake e ajo do
t'mbjonj fosën me uj par se ti. Ma ti mos bin e e mbjonj ajo më par, mbjoje
ti, se nj'mos ti des.

- Jo, mos u ngarikar - i tha ai.
- Ma gjegjëm mir, se ajo t'merr për çot e e mbjon ajo më par ujt e ti des.
Ti ka t'm'gjegjsh mua.

- Jo, se t'gjegjinj, mos u trëmb. Mos u preokupar se u t'gjegji tij. Bënj ashtu si thua ti.

Vate atje te kroj e gjeti kët pjake. Ajo pjaka i thot:

- Ka t'mbjonj u më par, se jam pjake.

- Jo, se ka t'mbjonj u!

Mbjoji ai më par. Mbjoji butiljet, muari e iku e vate mbrënda te e motra. U mbjodh më par se sa t'ishën katër e e motra ish gjith kutjend se i kish sjelj ujt.

Ditën apriesu pameta vate ki prinxhpi a kaça. Pameta i gjeti kta e i tha kumbarit (ç'ishën shinjanjura, se i kish pagzuar nj'bir):

- Ec, ikmi, ikmi, se kta ishën si di bilj ç'kish t'm'i bëj ime shoqe.

- Ma jore, kumbà, rrini, rrini!

- Jo, ikinj, ka t'ikmi, ka t'ikmi. U marr heljm, u des nj'mos.

Muari e iku e u mbjodh mbrënda tek mëma. Pameta i tha t'jëmës:

- Oj mo, nd'at an maljit te ai pulas si ishën një trim e një kopilje! Oj sa beljic kishën! Propju si ata ç'kish m'bëj ime shoqe...

Ajo e jëma i thoj:

- Jore, se ti je çot te kriet. Ec ha, se je i ljodhët! Ec fjëj!

Ai hëngri e vate sa t'fjëj. Pameta thrriti atë ç'ljaj ljugët, at serviturin, e jëma e i tha:

- Ej, ru', ec, se ti ng'bëre faregjë, ng'i mbilinarte, adhe jan ata...

- Ëh, mos u ngarikar, se menat vete pameta.

U nis e vate. Trimi pameta ng'ish, kish vatur, kish dalj; e gjeti at vashën e i tha:

- He, si je e bukur nani ç'ljahe! Ma nani t'mangon nj'etër gjë, nj'etër shurbes.

- E çë m'mangon?

- Një trim ç'është ndën dheut, ç'është kështu, kështu...

- Një trim?

- Ëh, ëh, një trim, një trim t'mangon!

- Oj - tha - e si bënj t'e kem?

- He, bitë t'gjënj me buz it vula, se ashtu e ke.

Pameta u mbjodh i vulau mbrënda e i tha kjo:

- Ej, ru', na kemi gjithsej, ma na mangon jë trim, ç'është kështu, kështu...

- Aù - tha -, motra ime, ç'vure ndë kriet ashtu? Jemi me gjith t'mirat e

nani na mangon një trim?

- Jo, nj' mos u marr helm.

I vulau i duaj shum mir. Sa t' mos mirrij helm i tha:

- Vete e t' e gjënj.

U nis menatet. Pameta ju përpoq ki pjakarelj:

- Ku vete? - tha.

- Ku vete? Vete se kështu, kështu, kështu... ime motër rri me buz; thot: dua një trim ç' është ndën dheut.

- Oj biri im, ç' ju vu ndë krie? Ma purke të m' gjegjsh mua, ti rriushirën.

- T' gjegji, t' gjegji!

- Ec ndë dejt, se atje posht është dejt, mirr kët shkarp çë t' jap u e bë nj' kriqe, se atje delj një trim, ma trim i bukur e jo ai nga ndën dheut e t' merr a braçu e t' thot: "Vemi mbrënda se t' gjegjinj tij".

E ashtu bëri: vate ktje posht ndë dejt, bëri nj' kriqe e i duali ki trim, tha: "Vemi mbrënda se t' gjegjinj tij". U muartën për krahu e van mbrënda. Van mbrënda e e motra kush t' e thot sa ish kutjend. U martuan bukur-bukur, hëngtën, pitën, bëtën festën...

Ditën apriesu pameta vate ki prinxhpi për a kaça me kumbarin e i gjeti kta. Inveçe se di, ishën tre. Van mbrënda ndë shpit e i thoj pameta t' jëmës:

- Oj mo, ru' se si ishën propju si ata ç' kish m' i bëj ime shoqe. Inveçe se di, gjeta tre... Si ka t' bënj? Si ka t' shkonj përpara njerzvet?

- Eja, eja, se t' thot kriet ashtu! Ec ha, ec ha!

Vate sa t' haj. Thrriti pameta e jëma atë ç' l'aj ljugët, at serviturin, e i tha:

- Ec nd' at post, ndë tal post, se ki o sonde o menat i gjën e kush t' e thot çë m' bënjën.

- Jo, jo - thoj ai - mos u ngarikar, se u di t' i gjënj.

Vate menatet servituri e e gjeti kët vashëzën. Ata, i shoqi e i vulau, kishën ikur ndë maljt. I tha ksaj vashëz:

- E ru' se si jini t' bukur ju. Jini tre, inveçe se di?

- Ëh, jemi tre - tha -, u martova.

- U martove? E je kutjend?

- Ëh, mora nj' trim i bukur, nj' trim i mir.

- Ru', kini gjithsej ktu, je e bukur, more nj' trim i mir, ma ju mangon nj' etër shurbes...

- Ç' na mangon? - tha ajo.

- Zogu çë këndon nd' mes shpis.

- Zogu çë këndon nd' mes shpis?

- Ëh, zogu, zogu, ma mos u ngarikar, se sa të t' gjënj me buz it shoq ti e ke.

Mbrëmnet u mbjodh i shoqi e e gjeti me buz. I tha:

- Ç'ke?

- Oj - tha - ç'kam? Erdhi nj'trim e m'tha se na mangon zogu çë këndon nd'mes shpis.

- E, - tha - gjithsej rriushirti, ma këtë ng'mund t'jet. Ku vemi e e gjëmi?

Vate i vulau pameta se e duaj shum mir motrën, u rritën orfaneljra, u rritën pa jëm, u rritën pa jat, e njera nani i gjeti gjith sa t'i ljipij, gjithsej ç'duaj. E vate e tha:

- Menat vete e t'e gjënj u zogun.

U nis sa t'vej t'e gjëj e pameta gjeti pjakun e i tha:

- Ku je e vete nani?

- Vete se ime motër do një zog çë këndon nd'mes shpis.

- Ru', biri im, nani vure nd'koc se do t'deshh daveru. Ae, ma për t'ljurtmën her të mbësônj. Ec nd'at shpi, ngjit ca shkal e nj'grua t'thot: "Mir se erdhe, mir se vjen kush sod na vjen, ma ng'bëre mir t'vinje...", ma ti mos u prir - tha pjaku - ti mos u prir, kur t'thot ashtu gruaja.

Muar ki e vate mbrënda e bëri si i tha pjaku. Përçë ng'u pruar, zogu i vularti nd'mes dorës e folji zogun:

- Vemi mbrënda nani, vemi tek shpia jote!

- E vemi - tha ki.

- Pero ruaj se ti mua ka të m'tratarsh mir.

- Ëh - tha - fighùrati! Për ndjet s'ime motër kush t'e thot se ç'bëra. Ëh se t'tratarmi mir.

U mbjodh tek e motra e ja dha zogun. Ditën aprësu vate pameta ai prinxhpi a kaçë. Vate atje tek pulasi e gjeti kta t'trea, e pa zogun e tha:

- E, ru' sa zog i bukur!

- Eni e hini - i tha ai trimi -, eni e hini.

Ai vate sa t'hij. I ofrirtën ata ç'mundjën, bën e hëngtën me gjith t'mirat, se pse ata kishën Krishtin me të, xhustamende kishën triesën sembri armatu.

- E - tha prinxhpi - poka menat ka t'vini tek na.

- A, jo. Ng'mund vimi, se na jemi katër veta, ng'jemi tre si njera nani.

- E pse ng'mund vini katër?

- Jo - tha -, ng'mund vimi, se na kemi zogun çë këndon nd'mes shpis e ng'mund vimi.

- Jo, e puru bën e vinj ai, bën e vinj.

- Ma mund vinj me katër veta?

- Jo, eni e qetu!

E vate mbrënda t'i thoj t'jëmës. Tha:

- E ru' se menat kemi njerz na.

- Jo menat, jo menat! Bin e vinjën të dial - tha ajo.

- Jo, vinjën menat! U ng'vete e i thom se t'bin e vinjën të dial.

- E jore, bin e vinjën të dial se u ng'mund pripararinj. Bin e vinjën të dial.

Kjo e jëma u fastidhis, përçë ai prinxhpi ish nuçendi e kjo ng'e kish kushenxën pulitu. Ki alura vate sa t'i thoj:

- Eni të dial se insoma jemi më komodhu të dial.

- Ëh, vimi të dial.

Të dial ajo srriti edhe atë ç'ljaj ljugët, at serviturin, e e bëri t'ngrent gjith me velen, kombletamende me velen sa t'i mbilinarij apena hajën. Sa arrvuan, t'jëmës (një ç'bën keq, keq gjën!) i erdh t'dridhurit.

- E ulji, ulji - thoj prinxhpi.

- Ulji, ulji - thoj e jëma e dridhej.

E u uljtën. Sa u vun ndë tries, vate zogu e tha:

- Nj'cik do t'fjas u pero. Më par sa t'hani, mos ngitni faregjë, faregjë, faregjë, se ka t'fjas u! Më par ka t'vete e përvonj gjith t'ngrent. Ju mos vëni gjë nd'goj.

Ata e gjegjtën zogun e ng'hëngtën faregjë. Si e përvoi ata t'ngrent, zogu diq mbi tries, diq për nj'cik her.

Dhopu u zgjua e tha:

- Nani pundarni, se mangon një nga triesa!

- Jo, se jemi gjith.

- Ma jo, se ng'jemi gjith - thoj zogu.

- Ma jo, se jemi gjith - thoj e jëma prinxhpit.

- Ma ng'jemi.

- E ndutu... më mir t'e dish ti se na? - i thojën patrunt e shpis.

- Epuru u thom se e di më mir u se ju. E rrini qetu. Eni gjith aprësu meje.

E kalar zogu e vate nd'ghaljinar teku kishën mbulitur t'jëmën e ktire fanxhuljve, t'shoqen e prinxhpit. Tha:

- Ka t'e sialni ljart ktë!

- Ma jo! - thoj e jëma.

- E alura ikmi gjith.

- Ikmi, dhopu se ng'duani atë, ikmi gjith puru na.

Ma prinxhpi muar alura e e sual t'shoqen ljart, e ngjitën atë t'zezën ljart, e tha zogu alura:

- Vëni nj'cik ver mbi atë!

Ja vun nj'cik ver mbi krie e divendarti e bukur si ish më par e e vun ndë tries. Zu zogu alura t'kundarij (zogu ish Zoti Krisht; nj'her e nj'her thojën se ish Zoti Krisht e e seghuirjën se si thoj ai, ahierna ishën nuçendi e nani ng'jan më), zu zogu sa t'kundarij:

- Suçidhirti kështu e kështu e kështu: jot shoqe - i thoj atij prinxhpi - kish bën di bilj, ma jot ëm ng'i duaj e bashk me atë ç'ljaj ljugët, me serviturin, van e i sualtën ndë muli. Ndë muli arrvoi molonari e kështu ju përpoqa u e i mbësova udhën ka kish t'vejën e i sola ndë pulas. Kur vate prinxhpi a kaça, vate ai servituri ç'ljaj ljugët e i dha ujt e dhopu kërkoi t'... e kështu e kështu e kështu i kundarti zogu gjith storjen atire mbrënda.

Ata u vjetën ljig.

- E runi se na skoprirti ki nani - thoj e jëma.

Njëherje sa kapirti prinxhpi i tha t'shoqes:

- Be', u ngë t'stesinj. Ç'stesinj u? Stesën mëma e stesën me serviturin. Nani zgjidh ti!

- Atë ç'do t'i bësh mëmës, zgjidh ti, përçë se, sa ike ti kaq mot e u rritën biljt, t'rrinja nd'ghaljinat me nj'thelj buk e me nj'bikër uj ditën...

- A, e ç'e do? Ti ke ljigj!

- Atë ç'ljaj ljugët, serviturin, digjn'je nd'mes qacës. T'ët ëm bëje si do ti, përçë është jot ëm e u ng'do t'e xhudhikarinj.

Serviturin alura e dogjtën nd'mes qacës e t'jëmën e ljidhtën me di mushka e e qeltën për ndë katund te kroi, te sheshi. Dhopu e bilja e i shoqi, ç'u kish martuar me atë ç'i kish dërguar Zoti Krisht, iktën e van tek shpia e tire. I vulau u martua puru e vate me t'shoqen. Prinxhpi muar t'shoqen xhustamende, përçë ng'stesnij, kish qën daveru ata se ç'thoj ajo, e nganjë u ghujdhir me fëmiljën e tij.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 54 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione 10.9.1968*

MATRIA

Nj'her u kish martuar nj'burr me nj'grua e kjo kish bën di bilj. Nani ki burr ish shum i bukur e kta di bilj i drëgoi ndë skol. Ish një vashëz e një djalj. Ajo e shkreta mjeshtre u kish namuratur nga i jati i ktire di fanxhuljve e i thoj atire:

- E ru'! U, ndëç disij jot ëm, e mirrnja u t'ët at, u ç'jam mjeshtre skole. Kush t'e thot se si ju mbanja, ju mbanja mir! Jot ëm ng'ësht pulitu; u ju mbanja nd'pëlëmb të dorës, kush t'e thot se sa kur u ju kishnja e ju thoja çë cikemika....

Ata fanxhulj nuçendi ngë kapirtën se dhopu ç'disij e jëma i vij ki shurbes. Tha djalji:

- Si ka t'bëmi na nani?

- E piami mjeshtren ç'ka t'bëmi - tha motra.

Van ndë skol e piajtën mjeshtren. Ajo tha:

- Kur jot ëm vete ndë sënduq (sënduqi ish i madh), ju ngrëni kuverqen, shtini kuverqen ndë trual, ashtu i pritët kriet e jot ëm des.

Ashtu bëtën. Than:

- Mo, duami buk.

Ajo e jëma, e zeshka, ng'dij faregjë, vate e mirrij bukën, e ata si e pan, van e mbullitën sënduqin e e jëma diq, u vjet me kriet mbrënda. U mbjodh i jati se kish vatur për dru ndë maljt, u mbjodh e tha:

- Pse, ku vate jot ëm?

- A - tha -, neve vate sa t'na bëj nj'cik buk e është posht.

Vate posht e e gjeti t'shoqen të dekur e kush t'e thot se sa heljm muari, përçë të shoqen ai e duaj mir, e muari shum heljm e ai i bëri gjith ata ç'kish t'i bëj, ma indandu, dhopu se e shoqja kish dekur, ng'kish çë t'bëj faregjë. E u bë shum mot pameta e ata fanxhulj vejën ndë skol. Mjeshtra tha:

- Diq jot ëm?

- Diq kështu e kështu - than kta, ma ishën nuçendi, ishën t'vikërr.

- Nani thuani t'it etit ndëç m'do mua.

- E si ka t'i thomi?

- Jo, mos thoni se jam propju u. Thoni se është një grua çë t'do. Mos thoni se jam mjeshtra, njëmos u ng'jam...

- A, jore - tha - se ng'ja thomi.

Van e i than t'jatit:

- E ru', ta, pse ng'martohe ti nani?

- A, jo, ng'mund martohem. Jot ëm ish keq e mir e u si bënj sa t'martohem e ju lë juve?

- A, jo, jo! - than -. Jo, jo, mos u ngarika, se na... Martohu e qetu!

- A, ahiera martohemi u, kur i kaljben këpuct s'at ëmi (se ajo u kish vjetur pa këpuc mbrënda). Ahiera martohemi u, kur i kaljben këpuct s'at ëmi.

Ata pameta menatet vejën ndë skol. Mjeshtra thoj:

- Si tha it at?

- A, tha se ahiera martohet tata, kur kaljben këpuct e mëmës.

E ajo tha:

- Poka vën'ji ndë kopre. Vën'ji ndë kopre se ashtu kaljben nj'here.

Ata fanxhulj muartën këpuct e t'jëmës e i vun ndë kopre. Kepucët u kaljbtën njëj kredi se ish dimër. Si u kaljbtën i than t'jatis:

- Nani, ta, këpuct u kaljbtën. Ti mund e marrsh një grua. Mund martohesh.

- Oj - tha - e juve si ju bënj?

- Jo, jo, na duami se ka t'martohesh.

- E kë ka t'marr?

- E ru' - tha - se ja thomi na mjeshtres çë na bën skol. E do?

- E dini ndëç m'do ajo?

- Jore se t'do.

Van e ja than mjeshtres. Ajo tha:

- Ëh!

E u martuan të dia, t'vrrat ata! U martuan, ma ata fanxhulj ngë stestën faregjë, stesi mjeshtra ç'i mbësoi. Shkoi nj'cik mot, pati një bilj kjo. Pameta kta di fanxhulj rritshën e l'inoçenxa i bëj më t'bukur, dit e dit i bëj më t'bukur. Ajo inveçe, bilja e saj, ish e brut, më e brut se fun'jarja.

Pameta kur u rrit, vate rregji se e duaj kët vashëz, t'parën vashëz, jo biljën e saj, ç'ish e brut, ma kët të bukurzën. Si bëri, si ng'bëri, i tha kjo vashëz:

- Jo, jo, se adhe jam e vogëlj.

- Alura ikni nga mbrënda - tha kjo matria.

Dhopy kjo i maltratarij, nga dita i zëj me ghrinj, i rrihij. Të biljën e saj inveçe e mbaj ndë pëlëmb të dorës. Iktën kta fanxhuljt. Iktën nga mbrënda, ma i kumbanjarti i jati, se i nditij keq. Mjeshtra i kish thën t'i vris.

- Ku vemi, ta?

- Vemi ndë maljt.

Udh e udh van ndë maljt, ndë dushqe.

- Ju rrini ati, se u minarinj ghaçën, se u vete për dru.

- E neve kur vjen e na merr?
 - Kur fërrnonj së bënuri drut, vinj e ju marr.
 Prit e prit ati ndë dushqe, i jati ng'erdhi më. Kish ikur. Ki djalji vu nj'qeramidhe sa t'strushulloj, ma ai kish ikur. Ata fanxhulj dhopu ndë dushqe buartën udhën. Buartën udhën e u vun sa t'qajën.
 - E nani ku ka t'vemi?
 - Ku ka t'vemi? Ku ka t'vemi? Vemi! Zëm'e ecmi! - tha i vulau, ç'ish nj' tutrëz më i madharjelj - E vemi ku na sial era...
 E zun t'ecjën udhës ndë dushqe. Ec e ec, i vij et ksaj vashëz.
 - Oj, se mua m'vjen et! Oj, se mua m'vjen et!
 - E si ka t'bëmi?
 E njo, u përpoq nj'pjak e tha:
 - Shih, shih se është një kruaruq ati përpara, ati posht. Ma se ndëç pini, një bëhet qëngjër ari e jetra bëhet vasharelje ari e ng'rrini më si jini.
 - E u ng'mund rresistirinj. U vete e pi, si bëhemi, bëhemi.
 Piu par e motra e u bë nj'vasharelje ari. Piu djalji e u bë nj'qëngjarelj ari.
 - E nani ku vemi e shehemi - tha - se ng'mund kumbarirmi përpara njerzvet kështu. Ru' si jemi. U jam qëngj. Vemi e shehemi!
 E van tek nj'kup kështënje ndë xhardin t'rregjit. Ng'kishën çë t'hajën. Vej ai qëngji in çërka. Ati ndë xhardin ishën ca ljakra. Ai vej e i spundarij me brit e i silij sa t'haj s'motrës. E njera se ç'hajën i zmiçarti rregji. Tha:
 - Ma kush ë çë ndë xhardin më bën ljakrat ashtu?
 Si bëri, si ng'bëri, vate e i gjeti. Sa pa at vashëz e pa se ish e bukur se ish ari, se kush t'e thot, tha:
 - Ka të m'martosh!
 - Jo se ti m'ljë, se kam t'im vula kështu e kështu, është një qëngj ari.
 - Mos u ngarikar, se u ngë t'ljë. E mos u ngarikar, se u ngë t'ljë ne tij ne vulaun.
 E martoi rregji kët vashëz ari, drëgoi karroca (ahiera uzarshën karroca, ng'ishën kta makna ç'jan nani) e kush t'e thot se sa fest bëri rregji. Duhshën mir, rrijën mir. Qëngji puru u gjënd mir ndë xhardinin e rregjit, kish bar t'njom, kish insoma gjithsej. Dhopu ca her erdhi sa t'e xëj matria ç'i kish rritur, kjo mjeshtërt skol'je, e vate sa t'i gjëj me t'biljën. Vate sa t'i gjëj, i gjeti e tha:
 - E ru' se si jini mir, se si jini t'bukur! Sa pulas i bukur, pero ka t'bin e shoh gjith kamrat.
 Tek një kamër rregji kish një pishikan: ng'ish i boçk, ma pishikan. Sa arrvuan (se rregji ng'ish, kur vate ajo), si arrvuan ktare vëçinu tek lu

pishikani, muar kjo matria e mutarti at vashëz, çë pritij xha një bilj o bir (ng'dij atë se ç'ish). E muari kështu e e ngjutirti pishikani at vashëz. Pstana kjo muari t'biljën e e vu ndë shtrat, te shtrati i rregjit, i tha t'hoj se ish e shoqja, se ish e smur e rrij ndë shtrat. Muari e iku kjo matria. Si iku alura kjo vashza mbrënda ndë pishikanin pati t'birin.

Vate rregji e pa t'shoqen (kët vashëz t'brut ç'kish vën e jëma ndë shtrat, matria, e rrij sembri smur ndë shtrat). I tha rregjit:

- Jam smur, jam smur. Erdhi mjedhku e m'tha se ka t'rri sembri me dritsore t'mbulitura, se ndëç një ë e hapt u ng'mund shoh dritën. Oj sa jam smur!

- E si ka t'bëmi sa t'shërohesh? - tha rregji.

- Ndëç do se ka t'shërohemi, ka t'bin e ha fikateljën e qëngjit ç'është ndë xhardin.

- U, Shën Mria ime! E duanja aq mir qëngjin, ti ç'thonje se ish një qëngj ari; nani si bëmi sa t'e vrasmi - thoj rregji -, se mua m'ndjet keq!

- Jo ka t'e vrassh, se u ka t'ha fikateljën! E alura thrrit ata ç't'e vrasnjën!

I thrriti. Alura qëngji u vu sa t'qaj:

- Oj motra ime, jan e limarnjën thik e ghaç sa të m'bin e marrën fikatin t'im.

Ju përgjegj ajo nga mbrënda ndë pishikanin. Thoj:

- Oj vulau im, oj vulau im!

Gjegji rregji e tha:

- Ma ç'është ktu mbrënda.

Vate sa t'shihij ndë kamër ku ish pishikani. Piajti pishikanin, tha:

- Ç'ke mbrënda ndë kurm?

- Kam t'ët shoqe - tha.

- E si bëre?

- E shtuan e u e hëngra - tha - e ktu pati puru një bir.

- A, e nani si ka t'bëmi sa t'e vialsh?

- A, ka të m'japsh një par shport me buk, një par shport me t'ngrën, se sa t'e nxier.

I shtu t'ngrënt e kështu nxuari t'shoqen me një piçirilj. E piajti rregji këtë:

- E si vete ç'u ndodhe atje mbrënda? Kur u nisa t'thash se ng'kish t'bustonje faregjë. Mund bustonje gjithsej, ma se ktu, se ktu ish pishikani e t'haj.

I rrispundirti e shoqja:

- Erdhi matria e m'gjeti - e kështu, kështu e kështu i kundarti lu fatu.

Alura rregji erdhi mbrënda e e njohu se ish e motra kjo ndë shtrat. E

picjartën ktë e e vun ndë nj'jaskun ktë t'motrën e ja drëguan mbrënda t'jëmës, matrës. E jëma, gjith kutiend se i kish ardhur paku, u vu sa t'haj. Vate maça e i tha:

- Ëme, ëme nj'cik mua!

- E jo, m'e drëgoi ime bilj e ka t'e ha u!

E rrij nj'cik e pameta i thoj maça:

- Ëme, ëme nj'cik mua, ë! Ru' se sa je e ha ti!

- Jo, m'e drëgoi ime bilj e ka t'e ha u - thoj ajo.

Alura maça ish e ikij. Dhopu kjo sa arrvoi te kriet, e njohu se ish e bilja.

U vu sa t'qaj. Vate maça, tha:

- Qaj vet nani! U ng'do t'qanj. Kur hëngre, hëngre vet, kur qan, qaj vet.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 54 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 16.9.1969*



“Vallet” Picili në vitet '60.

Le “Valle” a S. Caterina Albanese negli anni '60.

**MJESHTËR FRANXHISKU,
PRINXHPI ULJK E E BILJA RREGJIT**

Nj'her te gjitonia jon ish nj'pjakëz e kish di bilj ç'ishën një beljic të dialit, ma zëhshën sembri, përçë ahierna pititi kumandoj gjith ç'ishën. Ishën dekur uri gjith e vejën ture gjetur nj'shkarpi jasht o nj'gjë. I shoqi pij verën, pij shum ver, ma aq pij ver sa mbrijakarej. T'biljt mbetën nj'cik e mbetën t'di me t'jatin; pra, pse ai pij shum ver e ng'abadharij mëngu për ta, iktën. Ç'kish t'bëjën? Muartën e u nistën e van t'bushkarjën buk për ta e u vjet i shoqi e e shoqja. I shoqi nani thoj se i përcej vera, dilij nga nj'an e nga nj'etër e nj'dit i shiti sakunën e shtratit. U mbjodh mbrëmnet e shoqja e tha:

- Ma ti ç'bën ashtu?

- E! - tha - ru', ng'kishnja ver sot e e shita.

E shoqja maj se mund ish kutjend. Invendarti se kish t'bij bor e bënij tëtimit. Muari e i tha t'shoqit:

- Ma ka t'vesh t'gjësh di dru: sonde bën tëtimit, shkarpa ng'kemi. Ec, gjëj di dru se ngrohemi.

I shoqi përtoi sa t'vej se sa t'ngrohshën, pra i thoj kocës:

- Vete për dru se sa t'i shes për ver.

Si arrvoi atje ndë maljt i thoj kocës:

- Si ka t'bënj u sot pa ver? Kui ka t'i jap kto dru? Ja shes zotit? Jo. Ja shes atij? Jo. Ç'ka t'bënj?

Sa ish e rrij ashtu e srret nj'uljk mbrënda nj'ljimt:

- Mjeshtër Franxhi?

- Gje'!

- Eja ktu!

- E ku je? - thoj ai.

- Ec, eja ktu, se jam ktu.

E vej ture ruajtur nd'at ljimt, ture par, ma ng'ish se si t'e shihij. U hip mb'at an ljimtit, ish nj'fos e pa ktë, ish ki uljk. Tha:

- Ç'do?

- A, erdha sa t'bënja di dru - tha -, se u jam çë m'përquen vera.

- Purke m'e bën një mbashat - tha uljku - t'shkonj u ver sa do. Ma t'shkonj më se sa do ti.

- Thuajme! U basta çë m'jep nj'cik ver, vete ku do ti.

- Ka t'vesh ti tek e bilja rregjit. Ka t'vesh tek e bilja rregjit, ndëç m'do për dhëndërr.

- E bilja rregjit t'mirr nj'uljk!
 - U, sholja ime, ti ec se psanej shoh u ata ç'ka t'bënj.
 Ma ai ahierna, dhopu se i përcej vera, vate tek e bilja rregjit e i tha:
 - E ru', vika se kështu e kështu e kështu. Uljku m'tha ndëç t'e duanje ti.
 Ajo ç'ish më e hol se ai, thoj ndë kocht:
 - Ngë ka t'jet uljk, nj'mos... Njeri ë!
 Vate ajo psajna e i tha ktij mjeshtë Franxhiskut:
 - Thuaji: ndëçë m'bën shtratin ari, u e donja.
 Alura ki, mjesh' Franxhisku, u nis, vate pameta tek ljminti e tha:
 - Zoti uljk, zoti...
 - Gje'!
 - Ku je?
 - E jam ktu, jam ktu!
 - U mbashatën t'e bëra, pero ka të m'japsh verën.
 - Jo, vemi bashk.
 - Vika se ajo do shtratin ari. Ndëç ti do atë, do shtratin ari.
 - Ja bënj - tha ai -. Thuaji se ja bënj.
 Pameta u pruar. I dha sa doj ver, t'kishnje volja se sa i dha! Alura ki mjeshtë Franxhisku vate e i tha t'biljës e rregjit:
 - Ru', thuaji t'it eti e martohu, se ai shtratin ari t'e bën.
 Mbrëmnet u mbjodh i jati e i tha:
 - Papa, u u bëra nuse.
 - E me kë u bëre?
 - Me nj'uljk.
 - U, bilja ime, ç'bëre? Me nj'uljk u bëre nuse?
 - Epuru e donja. M'bën shtratin ari.
 - Po si? Nj'uljk t'bën shtratin ari?
 - M'e bën. Kur ng'e bën shtratin ari, ti fjit.
 Drëgoi e e muari poka. Alura u nis uljku e ki mjesh' Franxhisku e prisindarti tek e bilja rregjit.. Tha:
 - Nani e shihni ju. Si do t'bëni, bëni. Paguajm mua!
 I dha uljku ktij mjeshtë Franxhiskut sa deshi ai, e mbjoi me turre, e mbjoi se sa deshi, e ai vate tek e shoqja. Thrirti t'shoqen:
 - More!
 - Gje'! - tha.
 - Se u mbjodha.
 - E drut ku i vure?
 - I shita.
 - I shite? E sod si ka t'hami? Si ka t'ngrohemi?

- Mos u ngarikar, se sonde bin e hash mir.

Kur ja qeli turrest:

- Oj që m'bëri sa t'vej t'i vjidhij, nj'mos ku i gjënij gjith kta turrest!

- Jo - tha -, kur m'ljidhnjën mua, fjit ti. Mos u ngarikar, ti ha e qetu.

E shoqja i bëj shurbiset ndë shpi e bëj ata që kish t'bëj. Menat uljku me t'biljën e rregjit bëri darsëm. I bëri shtratin ari se si thonij ajo. Gjith katundi thoj:

- E ru', shurbes i brut: uljku muari t'biljën e rregjit, uljku muari t'biljën e rregjit... epuru i përqueu e bit e muari.

Dhodu që u martuan i tha dhëndrri nuses:

- E ru', ti ngë ka t'i thuash faregjë s'at ëmi, se ndëç i thuaje s'at ëmi, dhodu u vjetemi pameta se si isha. Ti mos i thuaj gjë!

- Jo, mos u ngarikar, se ng'i thom faregjë mëmës.

Alura u xhesh e u ndodh si nj'qeparis ki. Trim, se si trim! Ajo nga hareja ng'kish që t'bënij. Natën van sa t'fjëljen, ma ng'fjëljen fare. Pra nj'nat e jëma vate nj'here nj'here (se grat duajën prer gjuhën, se ng'e mbami maj një shurbes!), vate nj'her e jëma e tha:

- Bilja ime, u ng'kam si t'jap, kur nd'katund gjënj gjith që fjasën: "E runa ktu që shurbes: si bëri, si s'bëri, e bilja rregjit muari nj'uljk, e bilja rregjit muari nj'uljk!"

- A, mëma ime, ai m'përqueu, atë e mora.

- Ma u ngë kridhirinj se ti more nj'uljk.

- Jo?

Sa u ndodh që iku i shoqi, ajo i tha t'jëmës:

- Jore, se kështu e kështu e kështu...

Njera se që e jëma iku, ai u ndodh pameta uljk. Tha:

- E, se që m'bëre, sa t'ja kundarnje s'at ëmi! Nani kush e qan, e qan ti.

Ajo u vra nga heljmi. Ai i tha:

- U iki nga ti nani. U bëhem uljk, ng'mund rri me tij. Ik, e u vinj e t'pajuanj, vinj e t'gjënj ku je je.

Vate e iku ture qar tek e jëma, se tek e jëma kish faqe, te t'vulezrit nëng kish faqe. E vate e muari një shpiarelje, një kazet (si uzarshën nj'her nj'her, me shkarpa). E qaj gjith natën nd'at kazet. Sa qaj, thuaj:

- E ru' se që patirta, e ru' se që patirta!

Lamëndohej ashtu e ashtu; u ndodh e u façua nga finestrelja nj'cik e ndën finestreljes ish nj'pjak e i tha:

- E ru' se t' salvonj u. Mos u ngarikar fare, se kur ktu e nj'cik t'vinj uljku, ti ec ndë shtrat e thuaj: "Zoti Krisht, u vete e fjë me tij, me gjakun t'ënd mbëljojm mua!"

E daveru ajo ng'kish se si t'bëj e si kish t'vej e fjëj ndë shtrat, vate e tha kët ashtu si fjëj: "Zoti Krisht, u vete e fjë me tij, me gjakun t'ënd mbëljojm mua!". Ashtu kjo kazet u ndodh gjith gjak. Uljku hiri. Ma ai ish më i hol se ajo. Tha:

- Dite t'e bënje! Dite t'e bënje! E nani ç'dite t'e bënje, jam pameta se si jam.

Muari e u vesh si prinxhp e u ndodh nj'trim i bukur. Menatet (se e jëma e xu se ku ish e bilja) pameta vate e jëma. Vate e jëma atje e tha:

- Pameta je ktu, bilja ime?

I kundarti kjo t'jëmës:

- M'suçidhirti kështu e kështu e kështu...

Duali uljku psana e duali daveru si nj'drit. Vate e jëma e tha:

- Nani t'kridhirmi se është daveru dora e Krishtit!

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli* - Paese: *S.Caterina Albanese* - Età: *54 anni* - Istruzione: *elementare* - Genitori: *ambedue albanesi* - Professione: *casalinga* - Data della registrazione: *17.9.1968*

E SHKURTURA KARROC

Nj'her e nj'her ishën di xhuvinotra e nga nj'vashëz u kishën namurartur t'dia, ma i madhi vula ng'ja thoj t'vogljit, i voglji ng'ja thoj t'madhit. E nani si kish t'bëjën? Muartën një baket e van ture ecur t'di vulezrit.

- Ecmi!

- Ecmi! - thoj ai jetri -. Vemi nga kjo vinelje!

E jetri vula thoj:

- Vemi puru. Ti mirr kitarrën e u marr orghanetën.

E vate i madhi e i tha:

- Pero ktu ng'ka t'sonarmi, vet ecmi ashtu.

Ata u kishën bën sinjal me nusen. I pari, sa shkoi nga ndën dritsore, tringulisi baketën. Nusja u shkandar, se njohu sinjalin e baketës, e duali nga dritsorja e tha:

- Kush ë?

Sa nd'mes bëj kët e ljingoi e motra. Tha:

- Kush është?

- Ësht një trim që shkon e vete. Ësht një trim që vjen ktej.

Vate jetra, duali ndë dritsore, ish më e bukur se e madhja, se jetra motër, tha:

- Va çerka e duani t'ime motër? (Kur e thuaj për të motrën, e thuaj për vet'hen, vasha!).

- A, jo! - tha jetri.

I vulau i vikërr kish nu rrangore se i madhi sikur e kish qiqerjartur, ng'do t'ja thoj, ma mbeti puru me t'vulan. Ai u rraxhua, ma bit e kapirti se ng'ish fare gjë. Tha:

- Shko nj'etër her!

- E ëh! - tha i madhi e bëtë si u tha.

Mbrëmnet i vulau i tha t'vikrrit:

- Ku vete?

- U vete nga Kriqezit.

- E u vete nga nj'etër vend.

Pameta dualtën atje ku përpara. Nani ajo vashëz ngë kish se si t'bëj: i madhi i përcej e i voglji i përcej puru, ma u zun e vinxhirti i madhi, se deshi i vulau i nuses. Tha:

- Jo! Qe i pari, eja e t'bënj i pari!

E muari ki vashën. I vulau i voglji e nëmi të vulaun e madh e tha:

- Mos e ghuidhirsh kët nuse! E ru', i kishnje shtunur sit e ti bit bëra

gjith kët xhir. Kush t'e thot se sa bit bëra se kish t'e mirrnje ti! M'e kishnje thën se kish t'e mirrnje! Ng'ishën aq ashonje se sa t'bënje!

- E vi', vi' - tha - nani e marr u! E ti je kutjend se e marr u?

E muar, zu sa t'bij smur i shoqi. T'shoqes ng'kish çë t'i jipij. I vulau i vogël ng'do t'i ndihij më, përçë i kish bën atë e ng'do t'i ndihij. E alura ki shiti shpin. Shiti shpin e zu sa t'shërohej. Pameta vate e ra smur. Kish nj'kotëz e e shiti kotzën se ng'mund t'e paguaj jatroun e tha:

- E nani si ka t'bënj?

Deçidhirti sa t'shitij t'shoqen (ahiera andikamende i shitjën t'shoqet). I vulau i nuses duali ndë markat (se dhopu ç'u martua kjo motër ishën pjot me dëtitir ata e ki ghuanjuni, i vulau i nuses, vate ndë Turki e ahiera harrohshën se ng'ishën tuti sti mexi, ng'ishën telegrafî, telefoni, e ndutu harrohshën). Sa xu se shitshën kta njerz, ki i vulau u mbjodh nga Turkia e vate te ki markat sa t'bjej nj'nuse ç'e shitjën. Zu sa t'pij t'shoqin, tha:

- Sa e do t'bukurën?

- Ë, sa e donja? Po sa mban podhea cohës.

Ai mbjoi podhen e cohës me sa kish e e muari kët vashëz. E muari e ish e vej te katundi i tij. U vu mbi kalj (se ahiera uzarej kalji, vjaxharej me kalj) e u vun të dia, nusja e dhëndrri, e xhustamende, dhopu se ish i shoqi, ai e puthij ktë. Alura u ndodh se shkoi nj'zog atejna. Ki zog thoj:

- Ëh, puth vulau të motrëzën!

Alura kjo tha:

- Gjegj, trim, ç'thot zogu! - i tha t'shoqit.

- A, është një zog çë shkon e vete. Nani i vemi apriesu zogut? - thot.

Sa eci nj'cik, pameta e puthi. Shkoi zogu:

- Puth vulau të motrëzën!

- Çë thot?

E mbeti nj'cik, mbeti tizu sa t'e pijs se si srritej. I tha ki t'shoqes:

- Si srrite? Si srrite ti, vash?

- Katarin, mua m'e thon Katarine.

- Sa vulezër kishnje?

- Kishnja tre.

- E ku van?

- Një vate ndë Rrumani, një vate ndë Turki, jetri muari dhen e tij (se kish dekur).

Muari e pruari kaljin prapa e e suali pameta ndë markat. Vate in çerca sa t'gjëj kët burr, kush ish e kush ng'ish, njera ç'e gjeti. I tha:

- Xa t'bukurën, se ng'e donja!

- E pse ng'e do? E more, u kam bëzonj, shita shpin e kotzën, jatroun

ng'mund e paguanja, shita atë e ng'mund e bënj. Kush t'e thot se ç'shita e ng'mund t'e paguanj. Al'urtimu erdha sa t'shitnja t'ime shoqe e nani m'bëre kët trat... E nani, si ka t'bënj nani, u i mjeruami?

- E jo - tha -. U ng'e donja më.

- E mirr dhinarin që m'dhe poka, mirr dhinarin që m'dhe!

- Jo! Dhinarin që t'dhe ng'e donja. Kjo është palja e s'ime motër. Është ime motër kjo!

U njohtën e pameta zun sa t'puthshën, të mbracarshën e pstana ai vate ndë Turki e jetri vate te katundi i tij me t'shoqen.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 55 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 17.9.1969*



Kopilje nga Picilia me kostumin arbëresh.
Giovani di S. Caterina Albanese con il costume tradizionale arbëresh.

KOSTANDINI E FJURËNDINA

Ish një jëm shumë e mir e kish nënd bilj t' mir e të djetëzën një vash, ç' i thojën Fjurëndin. Kur njëherje shkoi ajo vorea, bushtra vorea, e ja muari tet bilj. U vjetën Kostandini, më i vikri, e Fjurëndina, e motra, ç' ish shumë e bukur, ish një beljic e dialit. Van sa t' e lji pjen për nuse, sa t' martohej, ma ng' duaj, përçë e jëma ng' e jipij. E nguliarti Kostandini, i vulau.

- Eja, martohu, motra ime! Eja, martohu!

Ma e jëma thoj:

- Jo, biri im, është keq larghu. Ng' e shoh më. Kush vete e m' e merr? Më muari bushtra vorea tet biljt: si ka t' bënj pa bilj u nani?

Kostandini i thoj t' jëmës:

- Vi', vi', se kur t' zë mali, vete e t' e marr u Fjurëndinën.

Alura e martoi kjo kët vashëz t' vetme.

Një dit pameta erdhi bushtra vorea e i diq ksaj jëm puru Kostandini, i mbrëmi bir. Alura kjo vej e qaj nga dita te grika tombës, e thoj:

- Kostandin, biri im, ku është besa çë m' dhe? Kostandin, biri im, ku është besa çë m' dhe? Besa jote ndën dhe! Besa jote ndën dhe, biri im!

Ki Kostandini alura u ngre nga tomba (ahiera kridhirjën Zotin Krisht, ç' nani u bëtënj gjith ebrej e ahiera kridhirjën). Gjithnjëherje u ngre Kostandini. Qatra u rëvëndar kalj, dera u rëvëndar selj, kalashini u rëvëndar vrilj, e m' u vu mbi kalj e vate te katundi i Fjurëndinës. Fjurëndina kish vatur ndë vale e ai gjeti vet t' birin. I tha:

- Bir, ku vate jot ëm?

- Mëma vate nd' val' jen.

- Rrango, bir, të m' e thrressh.

- E si ka t' i thom? - tha i biri.

- Eja mëm, se erdhi ljalja!

- Cili ljaljë, ti bir im?

- Erdhi ljalja Kostandin!

E vate. Sa arrvoi ndë vale i tha t' motrës:

- Lje e shprishe val' jen, motra ime! Lje e shprishe val' jen!

- E pse? - i tha e motra. Ka t' vish te katundi in, se mëmës i zu mali.

Ajo Fjurëndina lja e shprishi valen. Lja puru gjith t' biljt, la puru t' shoqin e u vu mbi te kalji, ngaljuar, me t' vulan. Udh e udhës rrij ture ruajtur t' vulan. Tha:

- Kostandin, vulau im, krahët t' ënd e bukurza, nani të mbuljhasurith.

- Motra ime, t' bënjën sizit.

- Kostandin, vulau im, shapka jote e bukurza, nani e mbuljhasurëz.
- T'bënjën sizit, motra ime.
- Kostandin, vulai im, kalji it i bukuri, nani i mbuljhasurith.
- T'bënjën sizit, t'bënjën sizit, motra ime.

Pra arrvuan ndë katund e pa dritsoret t'zonjës mëmë gjith t'mbulitura.

Tha:

- Kostandin, vulau im, dritsoret t'mëmës gjith ishën t'hapta, e nani pse t'mbulitura?

- Sod qe era ndë katund.

Dhoku arrvuan te qisha. Tha Kostandini:

- Ti, motra ime, ec tek mëma se u vete e mbulinj kaljin.

U hap qatra e ai u ngulj mbrënda te varri. Alura kalji u rëvëndar qatër, selja u rëvëndar der, vrilja u rëvëndar kalashin e u mbuli mbrënda te loku i tij e e rriçitarti Zoti Krisht.

Fjurëndina busarti tek e jëma:

- Mëm, eja e m'e hap derën!

- Ik, ti je bushtra vore! - thuaj ajo -. Më more nënd bilj e do të m'marrsh puru mua.

- Eja hap, mëm, se jam Fjurëndina.

E pameta ajo:

- Ik, ti je bushtra vore (bushtra vore është mortja, jo?). Më more gjith nënd biljt e do të m'marrsh puru mua?

- Jo, mëm, se jam Fjurëndina, eja m'hap!

U kalar, hapu. E jëma e hapu derën, pa se ish Fjurëndina, bilja e saj, e shtrëngoi jëma e shtrëngoi bilja, diq e jëma edhe e bilja e u vjetën ashtu.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 54 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.9.1968*

VULAU E MOTËRZA

U kish martuar nj'bur e kish marr nj'xhoj grua. Pstana ra smur. Ra smur e ng'kish si t'i mirrij medhiçinat. Kish trapitin e e shiti, kish kotën e e shiti. Alura qe kostretu t'shitij t'shoqen (se ahiera uzarej ashtu), ma jo se ng'e duaj mir, ish se s'kish se sa t'paguanij. Vate e e qeli ndë markat kët vashëz. E qeli ndë markat, i vu velin (se uzarej veli ahierna). Atje duali nj'trim ç' vij propju ka Turkia, pa kët vashzën e i tha:

- Sa m'rri e bukurza?

- Po sa mbjon podhen e cohës.

Ai muari podhen e cohës, ja mbjoi me turre e muari t'bukurzën. Ai i shoqi iku. U vun ngaljuar, ecjën ecjën kta udhës. Njize bën nj'zog:

- Ciu-ciu. Puth vulau të motrëzën.

E ajo i thoj:

- Gjeggj, trim o, çë thotë zogu!

- Zogu shkon e vete.

Pameta ikjën. Kavalu kavalu van njera te një malj. Atje bën zogu:

- Ciu-ciu. Puth vulau të motrëzën.

- Gjeggj, trim o, çë thotë zogu!

- Ësht zogu çë shkon e vete.

Ma ai i tha ksaj vashëz dhopu:

- Sa vulezër kishnje, vashëz?

- Kishnja tre vulezërith: një më vate ndë Turki, një më vate nd'Rrumani, jetri muari dhen e tij.

Muari ki ahierna kaljin, ç'ish ngaljuar mbi të, e e pruari prapa ndë markat e vate ture gjetur kët burr ç'i kish dhën të bukurzën. E gjeti e i tha:

- Xa të bukurzën!

- E pse? - i tha ki.

- Jo, ng'e dua!

- Xa dhinarin çë më dhe.

- Jo, dhinarin çë t'dhe ng'e dua. Ajo është palja e s'ime motër e ng'e dua.

Finishi se ki ç'e kish bjejtur kët vashëz ish i vulau. Ashtu e pruari të bukurzën ktij burrit, i dha turre e ashtu paguajti kotën, paguajti trapitin, paguajti gjith dëtirt ç'kish ki i shoqi e vivirti me t'shoqen, e ai, i vulau, u martua me nj'etër vashëz.

Narratrice: *Cristina Pisarri - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 87 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 27.8.1967.*

I SHOQI E E SHOQJA

Ish nj'her nj'shoq, nj'burr, ç'kish t'shoqen ç'ish nj'cik çotinje. Sembri i thoj se ng'ish mir se si bëj ai. Nj'dit i shoqi haj çdo zogj, çdo palumba t'pjekura.

- Si jan sapuritra kta palumba! - tha.

E shoqja i thoj:

- Ma ng'jan se si i srret ti, se srriten ndë nj'etër manerje. Srriten grifsha.

Ai thoj ndë një manerje e e shoqja thoj se ish nj'etër, se ng'jan palumba, se jan grifsha. I shoqi thoj:

- Jo, jan palumba!

- Jo, jan grifsha!

I shoqi thoj jo, e shoqja thoj ja, njera ç'u zun e u rrahtën. U rrahtën mir e mir. Shkoi nj'vit e i shoqi i tha t'shoqes:

- E mban mend se kët vit çë shkoi, vjet, hajëm na ata zogj të pjekur ç'ishën palumba?

- Jo, ishën grifsha!

- Jo, ishën palumba!

I shoqi thoj se ishën ndë një manerje e e shoqja thoj se ishën ndë nj'etër. T'shoqit pameta ju ngjitën aq shum, sa muari e rrahu t'shoqen njera se bin e diq.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 55 anni - Istruzione: elementare - Professione: casalinga - Genitori: ambedue albanesi - Data della registrazione: 16.8.1969*

PREDHIKATURI E DHIA

Nj'her vini për ndë katund një monak i huaj. Ish një ç'predhikari mir e insoma gjith e gjegjën, gjith, kush t'e thot se sa i bëjën. Ki monku predhikarij, predhikarij e një grua ndë qish qaj. Ki predhikarij, ajo qaj. Kur duali, predhikaturi i tha asaj gruajës:

- Pse je e qan? Për ato predhka ç'bëra?

- Jo, ngë m'përqeu predhka, ma qajta pse dje m'u fukar një krapet, një dhi, që t'gjat tij, ç'e kish bekun tale kuale si ti.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 55 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: Casalinga - Data della registrazione: 16.8.1969*

NGË JAM NGA KI KATUND!

Ish nj'her nj'predhikatur. Aq predhikarij mir, ç'i përcej gjithve, e qajën, jo? Vet një ng'qaj. Dhopu predhikaturi e pajti ktë:

- Pse ng'qan?

- Pse ng'jam nga ki katund!

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 17.8.1969*



Proçesion për festën e katundit (30.5.1965).
Processione per la festa patronale.

JUDHÇI

Nj'her ish një çë ng'dij e bëj faregjë. Vate tek nj'mik nga t'tijt e u kunxiljua si kish t'bëj.

- Si ka t'bënj sa t'ghadhnjenj gjë?

Ai miku nëng kish si t'e kunxiljoj më e i tha:

- A, bë judhçin!

- Ma u nëng di e i bënj sendenxat. Si bënj sa t'bënj judhçin?

Ai miku i tha:

- Bë judhçin! Bë judhçin! Nëng duhet faregjë. Mund e bësh, se t'mbësonj u. Shkruaji ndë nj'kart, shkruaji nga pes vjet sendenxat, shkruaji nga shtat vjet, shkruaji nga dhjet vjet, shkruaji për të dekur e si t'kapitar, e i mban ndë nj'bors, ndë kushal, e dhopu, si t'kapitar, si t'vinjën njerzit, si kush t'vjen, heljq sendenxat nga kushala.

E ai gjith kutjend vate ture ecur e bëri si i kish thën miku. Një dit erdhi një ç'rremon, ç'rri jasht katundit, e i tha atij se kish nj'kauz e doj bën sendenxën. Judhçi, ki çë ng'dij e bëj fare gjë, muari një sendenx nga kushala e e kundantarti për dhjet vjet pa ç'kish bënur faregjë. Ai kondadhini, i ziu, nëng kish bënur faregjë, jo?, e i thoj:

- Mua mos m'jip gjith kta pen, se nj'mos m'rruvinarën biljt, m'rruvinarën fëmiljën, m'rruvinarën gjith. Kam t'ime shoqe, kam shtat bilj, e u si ka t'bënj?

Ma judhçi, dhop'se ng'kish ndonj'etër vaul, i tha:

- Minu mali se ngë t'dhe se sa t' kishnje dekur propju, pse nd'kushal kishnja puru at kundantart ç'ish la pena për të dekur. Mund kishnje dekur, jo? Kishnja puru kundantart ç'mund t'jipja se sa t'disnje, e kisha ndë kushal.

Kështu vate ki kondadhini gjith kutjend.

Narratrice: Agata Raico - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 64 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.8.1969

PREDHIKATURI E BISHTI I DJALIT

Ish nj'her nj'predhikatur që kur predhikarij thoj shumë shurbise që ng'ishën. Më shumë kur thoj se kish matij gjë, inçe se një, thoj nj'etër. Ndaj një ditë i srriti sakristanit e i tha:

- Kur u predhikarinj, ti rri prapa meje e kur u thom nj'shurbes që ng'ë, m'tirarën për tirqi.

Ai i tha:

- Ëh, se bënj ashtu si thua.

Predhikaturi alura zu sa t'predhikarij për pisën, për djalin ndë pist, e tha:

- Vulezër t'dashur, e dini që është djali? Djali është nimiku të kështevet. Është i madh djali! E dini sa e ka bishtin? Djali e ka bishtin që është një milj metër, nendimenu!

Sakristani e tirarti për tirqi e i tha:

- Mos thuaj ashtu, se ng'është ashtu!

Predhikaturi alura e rridhuçirti e tha:

- Vulezër, djali ng'e ka bishtin propju një milj metër, përçë një milj metër jan shumë, ë një kilometr, ma sikuru se e ka pesqind metër.

Pameta sakristani e tirarti për tirqi se ng'ish ashtu. Dhopu ki predhikaturi tha:

- Vulezër t'kështe, u thoja pesqind metër, ma është edhe shumë pesqind. Djali e ka bishtin diqind metër.

Sakristani tirarti pameta. Predhikaturi e rridhuçirti e rridhuçirti e dhopu tha njëqind, dhopu pesdhjet e al'urtimu e rridhuçirti ndë pes metër. Sakristani e tirarij sembri, tirarij, tirarij... Dhopu ki predhikaturi u rraxhua e tha:

- Ture gjegjur kët çot ktu, që m'tirarën për tirqi, vulezër, do t'e dini se djali është nimiku të kështevet, ma nëng ka fare bisht?

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Professione: casalinga - Genitori: ambedue albanesi - Data della registrazione: 16.8.1969*

DHIA, ULJKU E LJAKRAT

Ish nj' burr ç'kish bjejtur nj'uljk nga çdo kaçatur, dhopu nj'dhi e çdo ljakra ndë markat. Ecij ecij e gjeti nj'ljum.

- Si bënj u nani sa t'shkonj mb'at an ljumit? Gjith një herje ng'mund vemi ndë vark. Ndëç shkonj par ljakrat, uljku ha dhin. Ndëç shkonj par uljkun, dhia m'ha ljakrat.

E ture penxuar me krie thot:

- U si ka t'bënj?

Dhopu, ture penxuar, ture penxuar, i erdhi ndë kriet:

- Më par shkonj dhin e ljakrat!

Lja ljakrat e u pruar prapa me dhin. Lja dhin e muari uljkun e e shkoi mb'at an ljumit e u pruar pameta prapa. Muari dhin e ashtu i salvoi të tre, dhin, uljkun e ljakrat.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 55 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Data della registrazione: 17.8.1969*

SHËN PJETRI E DJALI

Kish t'martohej Shën Pjetri e suali djalin për mbashatur. E ish puru nj'etër bashk. Sa u hiptën te shpia nuses, thoj:

- Pjetri është i mir!

Djali thoj:

- Ësht i mir daveru!

- Pjetri është një xhoj njeri!

- Ësht i mir daveru!

Ki kumbari ç'ish puru me të (ng'e di kush ish) i thoj puru ashtu:

- Pjetri shurben sembri.

- Shurben daveru.

- Pjetri - tha - indandu sheh mir.

- Jo, është çikat propju! - tha djali.

Si gjegji kështu nusja, muari e e lja e ng'e deshi më Pjetrin.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli* - Paese: *S. Caterina Albanese* - Età: *55 anni* - Istruzione: *elementare* - Genitori: *ambidue albanesi* - Professione: *casalinga* - Data della registrazione. *18.8.1969*

MONAKU I BUZURAKS

Ish ktu Picilji një monak ç'i thojën "Monaku i Buzuraks". Kështu ish përndominatu Padre Antonio Santori e Buzuraka ish katundi. Ki ish filosofo, shkruajti shum rrëmënxa, shum kënka, bëri arghaljin, bëri pjanofortin, bëri kaldajën a vapore, bëri shum cika. Ndë katund ish puru një varvìar, ç'bëj varvën, e i thoj ktij Padre Ndonit:

Monaku i Buzuraks
shiti telj e lesh e spak.
Vate e eci gjith dhen,
Picilji u mbjodh si nj'qen.

Ma ki, ç'ish filosofo, i rrispundirti njëherje e zu e i tha ktij varvìarit:

Jam Monaku i Buzuraks,
bënj telje, rroman'jelj e spak.
Vajta, eca e u mbësova,
u bëgata e u nderova.
Sa u kam ndë nj'rrazuqe
ti ng'e ke nd'at shpiaruqe.

E kështu ki e vinxhirti kët varvìarin.

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 16.8.1969*

KOSTANDINI E JURËNDINA

Ish nj'mëm shumë e mir e kish puru nënd bilj t'mir e një t'vetme një vash. Vejën e vijën për kushqi te kjo vashëz, ma e jëma nëng e jip. Arrvuan për kushqi ca atje ndë dejt.

- Bëmi, mëm, at kushqi! - i thoj i vulau i ksaj vashëz, Kostandini, përçë do t'e shih t'martuar t'motrën - Bëmi, mëm, at kushqi!

- Jore, bir, jore, jore! Udha është keq larghu. Kur t'e dua u mb'gaz, kush vete e m'e merr? E kur t'e dua u mb'ljip, kush vete e m'e sial?

- Vete u, mëm, e t'e sial. - thoj ki, Kostandini, i biri.

E martuan dhopu ket vashëzën, ç'i thojën Jurëndina. Alura m'i arru nj'vit i rënd e ja muari nënd biljt mëmës. Alura vij e gjëmura, e jëma, ndë qish e qaj e thoj:

- Kostandin, biri im, ku është besa çë m'dhe?

- Besa ime ndën dhe! - rrispundirij ki, i biri, ç'ish ndën dhe, nd'varr, ç'kish dekur.

Alura ki u ngre. Varrin e bëri kalj, qatrën e bëri selj, vokulën e bëri vrilj e m'u nis e m'vate. Vate tek t'biljt e t'motrës e i tha:

- Bir, ku vate jot ëm?

- Mëma ljuan val'jen - i than ata.

- Rrango, bir, e m'e srrit!

- Ma ng'e di si ka t'i thom.

- Eja, mëm, se erdhi ljalja, erdhi ljalja Kostandin!

Ata van e i than mëmës:

- Eja, mëm, se erdhi ljalja!

- Cilji ljaljë, biri im?

- Erdhi ljalja Kostandin.

Dhopu, kur u pan, i tha kjo e motra:

- Kostandin, vulau im, cilja erë më të suali? Si erdhe ti këtu?

- Më suali bushtra vorea! - i tha ki.

- Ndëçë m'erdhe ti mbë gaz, veshemi si m'sole nuse. Ndëçë m'erdhe ti mbë ljip, nisemi si kologhre.

- Nisu si të zu hera, motra ime, nisu, 'et vemi te mëma.

Alura u ngaljua ki i vulau, Kostandini, e e motra, Jurëndina, u vu ngaljuar sikur prapa. E si udhës ngaha m'vejën i thoj:

- Kostandin, vulau im, një sinjal të keq u m'shoh: krahët t'ënd të bukurza, i shoh të zgobjaturith, t'vjerrur.

- Vash, t'bënjën sizit.

- Kostandin, vulau im, si vemi nani atena? Një sinjal të keq u m'shoh: shapkën hol të bukurzën, m'e shoh të mbuljhasurëz.

- Është pjuhuri i udhës, pjuhuri i udhës vet - tha ai.

E alura vejën adhe:

- Kostandin, vulau im, një sinjal të keq u m'shoh: finestrat e zotit ljalj, m'i shoh të nxirraturaz.

- Frinij era ndë katund - tha.

Alura m'i arrun te dera qishës e i tha ki motrës:

- Shko përpara, Jurëndin! Shko te mëma!

- E ku vete, Kostandin?

- Vete nd'qish të faljiem. Vete sa t'salutarinj Zotin Krisht - i tha i vulau.

Alura kjo, Jurëndina, vate tek dera e t'jëmës. Tha:

- Hap derën ti, mëma ime!

- Nëngë kam u bilj, jo më!

- Hap derën ti, mëma ime!

- Nëngë kam u bilj, jo më! Mos je ti bushtra vorea? Më more ti nëndë bilj, do të m'marrsh ti adhe mua?

- Hapëm, mëm, jam Jurëndina, Jurëndina, jotë bilj.

- Jurëndina, ime bilj?

Hapu derën. Shtërngo e jëma e shtërngo e bilja, diq e jëma e diq e bilja, diqtën të dia e kështu u fërrnua shpia e u fërrnua puru rrëmënxa.

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.8.1969*

KOSTANDINI I VIKËRR

Nj'her e nj'her ish nj'mëm shum e mir e kish di bil, nj'djalj e nj'vashëz. Djaljit i thojën Kostandini i vikërr e vashzës i thojën Rinuljen. Ki Kostandini u martua e muari nj'nuse t'mir. Tri dit dhëndërr ish, nënd vjet ndë suljdet, njize duaj t'vej suljdat, e kish srritur rregji suljdat, ndë ghuerr për nënd vjet. Muari e vate. Par sa t'vej u puth me t'jëmën e me t'motrën, e ksaj nuses, s'bukurës, i muari unazën nga gjishti e i tha:

- Prit nënd vjet e prit nënd muaj, nj'mos martohu!

E vate ki. Muari kaljin, u ngaljua e vate suljdat te rregji nd'ghuerr me Turqit.

E alura kjo e bukurza, nusja e Kostandinit, priti e priti e ki nëng u turnar. Shkuan nënd vjet e shkuan nënd muaj e Kostandini i vikërr, dhëndri i saj, pa se maj vij. Ish e mbrëmja dit e gjeti nj'etër dhëndërr, nj'etër burr adhe, e kish t'martohshën.

Kostandini i vikërr ish atje te rregji. Ish e fjëj atje ndë kazerm me suljdet. Ish e fjëj, njish ng'i zëj gjumi, ish e shërtoj mbrëmnet, ish e shërtoj shum fort.

- Kush ë e shërton? - tha rregji.

- Kostandini i vikërr - i than.

- Ç'ke e shërton? - i tha rregji.

- Sot martohet nusja ime. Shkuan nënd vjet e shkuan nënd muaj, sot martohet bukurza, vë kuror me nj'etër burr.

- E alura - i tha rregji - ke permes.

Se përçë dhopu i dha kaljin e i tha:

- Kalaru ndë staljzit e zgjidh më t'mirin kalj. Mirr t'kuqin si shega.

Ma nëng e desh i t'kuqin si shega, ç'ish kalji i kuq. Tha:

- Ai m'pjasën zëmrën.

- Mirr të ziun si uliri! - i tha rregji.

- Ai më nxin zëmrën, përçë u jam i zi çë m'martohet nusja e u jam kurora e par.

Alura i tha rregji:

- Kalaru ndë staljzit, mirr ti shoshin me eljb e zgjidh më t'mirin kalj. Mirr të shpejtin si petrity.

Alura Kostandini e muari të shpejtin si petrity, u ngaljua e u nis e m'vate si era. Udhës e udhës ka m'vej ju përpoq e motra:

- Ku vete, e ljumja vash? - i tha ki.

- Vete më gramisiem. Vete e gramisemi. Sot martohet ime kunat, nusja e Kostandinit.

- Priru prapa, motra ime, se jam ure Kostandini. Jam u it vula, ç'jam e mbjidhemi mbrënda.

- Alura priremi t'di.

Udhës e udhës si ecjën, ju përpoq e jëma.

- Ku vete ti, zonja pjake?

- Vete më gramisiem. Sot fidharet ime re, nusja e Kostandinit.

- Priru prapa, zonja mëm, se jam ure Kostandini.

- A, ti je Kostandini, Kostandini, biri im?

Arrvuan. Alura vate përpara ki te dera qishës:

- Bëni largh, ju buljar, se jam u kurora e par!

I dha unazën e e muari ai kët nuse, t'parën nuse, ç'ish e tija.

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.8.1969*

VULAU, MOTRA E NUSJA E LJIG

Ish nj' motër e nj' vula që më duhshën keqë mir.

- Mirë mbrëma, motra ime!

- Mir se vjen, vulau im!

Kur nisej menatet i vulau i thoj:

- Rri mir, motra ime!

- Me shëndet, vulau im!

Nj' ditë ki i vulau i tha t' motrës:

- Martohu, nani ti, motër, martohu!

- Jo, martohu ti, vulathi im! - i tha ajore - , se u me t'ët shoqe bënj, që jemi gra, ma ti me t'im shoq, që është burr, ng'bëni.

Alura u martua i vulau e muari nj'grua. Ma kjo e shoqja ish xheluze nga e motra se i thoj sembri t' motrës "Mirë mbrëma!" e "Rri mir!", e jo t' shoqes. E alura dhopu, sa t' bëj dispjet, e shoqja muari e shtu gjith ata grurt mbë trual. Kur u mbjodh mbrëmnet i tha ki pameta t' motrës:

- Mirë mbrëma, motra ime!

- Mir se vjen, vulau im!

- A, kjo motër, motër qene, ka shtunur gjith kashunin me grurt mbë trual.

- Bëri mir! Ajo e kuistarti, ajo e shtu - tha i shoqi.

Dhopu mbrëmnet edhe kjo shtu xharrën me valj mbë trual. Pameta:

- Mirë mbrëma, motra ime!

- Mir se vjen, vulau im!

- A, se kjo motër, motra jote, të shtu xharrën me valj mbë trual.

- Bëri mir. Ajo e kuistarti, ajo e bëri.

Dhopu parturirti e shoqja e bëri di bilj xhemelj. Si nëng kish se ç't'i bëj dispjeta përçë "Atë e bëri mir se e shtu, atë e bëri mir se e shtu", muari ajo e shoqja nj' thik e therti t' dia biljt e i vu ndë shtrat. U mbjodh pameta i shoqi mbrëmnet e tha:

- Mirë mbrëma, motra ime!

- Mir se vjen, vulau im!

- A, kjo motër, motër qene). Po ec shih ndë shtrat!

- E që është? E që bëri?

Vate nd' shtrat e gjeti t' dia biljt të vrar e thikën viçinu.

- A! - tha -, motra ime, gjithsej të bëra pasu, me me këtë jo!

Tha kjo:

- Jore, vulau im, se ng't'e bëra u. Se u ng'shtura ne grurt ne valjt, ne

biljt t'vrava u. Ngë t'i vrava u, t'i vrau jot shoqe.

- A! - tha - ma indandu, motra ime, nani si ka t'bënj? U biljt i donja karu e tij t'donja karu puru, ma nani mbrënda ng'mund t'shoh më.

- Ec e shuljaru! Ec e shuljaru! Ec e shuljaru! - i thoj kjo e shoqja.

Elura muari ai t'di ata fanxhulj mbraca e t'motrën e van ture ecur. Van e i lja ndë maljt. Ma dhopu linjën e s'motrës ç'kish llier me gjak ia suali t'shoqes mbrënda...atij të vulaut i nditi keq se kish t'vritij t'motrën e e vu te nj'puc viçinu te nj'malj e i thoj:

- Ec ndë maljt e rri!

Dhopu ajo qaj e qaj e qaj. Qajti, qajti e qajti, njera ç'me ljot mbjoi nj'korqe ve. Ish me ata ljot, u përpoq nj'pjake e i tha:

- Ç'ke ti ati?

- U ç'kam? Ësht nj'mot ç'im vula ngë mund m'shoh.

Ajo i kundarti gjith storjen. Alura i tha pjaka:

- Be', alura ti e ke forcën sa t'mbjosh kët me ljot, kët jetër korqe ve me ljot?

Tha ajo motra:

- Ëh, mbjonj puru dhjet korqe ve sa t'qaj.

Kjo pjaka i tha:

- Xa, mbjo at ashonje e me nj'pend (i dha nj'pend) dhopu ljiayi kta fanxhulj me ljot, ljiayi!

Alura kjo, dhopu ç'qajti e qajti e qajti, mbjoi at ashonje, korqen e ves, e i ljiajti ata fanxhulj me ljot gjithparu e ata u bëtën t'gjal, u bëtën t'gjal ata fanxhulj. Nani ksaj i tha pjaka:

- Xa nj'baket (i dha nj'baket)! Bin e xhirarinj ki mashkuli - i tha, se ish nj'mashkul e nj'fëmër.

E bin e xhirarti tornu tornu e u ngjaltën kta fanxhulj e u vun e xhirartën njera çë ng'mund xhirarjën më. E gjëj e gjëj e gjëj nd'at malj e gjetën çdo njerz nd'malj, gjetën një pulas të boçk me gjith shurbiset, të ngrënt, e u vjetën ashtu për ca vjet.

Dhopu ca her vate a kaça ki i shoqi me nj'kumbanj. Vate a kaça e vran një ljepur. Vran një ljepur e i tha ki kumbanji:

- Do t'venja e e bënja te ki pulas.

- Jo, u ng'vete, ecni ju!

Vate alura sa t'bëj ljepurin, sa t'e piqij kumbanji e ishën ata di fanxhulj çë lozjën e thojën:

- Një, di e tre, jemi t'biljt e ljaljës Ndre.

Pameta:

- Një, di e tre, jemi t'biljt e ljaljës Ndre.

Kur ish e bëj ljepurin, ajo grua, e motra, i thoj atij helit:

- Piqe, digje e mos e piq! (se ish i fatartur puru heli se ç'e piqij misht).

Piqe, digje e mos e piq!

Kur van sa t'hajën, e hajën t'krudh e t'djegur. Vate puru i vulau e i tha:

- Permesu? - tha sa t'hij nd'at vend; ljiu permesu sa t'hij.

- Hini, hini! - tha dera, se ish dera puru ç'fjitij, se ish e fatartur.

E bin e hiri. U hip. Dhopu ç'u vun sa t'hajën, i tha vrokës kjo:

- Vrok, dhopu ç'fërrnon së ngrënuri, ec te kushala zotit.

Dhopu ç'hëngtën e ç'pitën, van sa t'mirrijën nj'vrok sa t'mbjidhjen shurbiset e mangoi vroka. Ajo dhopu e srriti:

- Vroka ime, ku je?

- Te kushala zotit - rrispundirti ajo.

Ai u skal'jua, u skal'jua e gjeti vrokën ndë kushal.

- E! vulau im - tha ajo.

Dhopu ajo u prisindar se ish e motra.

- E! vulau im, si ti ng'dite vrokën ç'rrij te kushala jote, kështu ng'dita u thikën çë t'vrau biljt t'ënd, se biljt t'ënd i vrau jot shoqe e jo u! Grurt e shtu jot shoqe, valjt e shtu jot shoqe!

E alura tha ki:

- Vemi tek shpia se e xhustarmi t'ime shoqe!

Bit van mbrënda e tha:

- Ti si e do t'ime shoqe?

- A! si e donja? Si m'deshi ajo mua! Ajo m'deshi se kish të m'vritij e u donja t'e djeg t'gjal atë. Si m'deshi ajo, donja edhe u!

E bin e e vrau t'shoqen dhopu ai, u ghuidhir me t'biljt e t'motrën e gjëlitën bashk.

Narratrice: *Agata Raico - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 64 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 17.8.1969*

VISTËR FJALJËSH - FILASTROCCA

- Kikiriki, gjelji i zi,
ç'bëri pulja ndë muli?
- Bëri tri kuljeç me hi:
një e poq, një e dogj,
një e hëngri me gjith zogj.

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.8.1969*



Moment feste në katundin e Picilisë.
Momento di festa nella comunità di S. Caterina Albanese.

VISTËR FJALJËSH - FILASTROCCA

- Motra, ime, motra ime, ku je?
- Jam te kroj e ruanj qe.
- E qet ku jan?
- M'i hëngri uljku.
- E uljku ku ë?
- E mbitën qent.
- E qent ku jan?
- Van ndë maljt.
- E malji ku ë?
- E dogji zjarri.
- E zjarri ku ë?
- E shuajti ujt.
- E ujt ku ë?
- E piu zogu.
- E zogu ku ë?
- E vrau kaçaturi.
- Kaçaturi ku ë?
- Vate mb'krua,
m'gjeti mua
e u martua.

Narratrice: *Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.8.1969*

FJALJË ARI - PROVERBI

E tër jeta peta peta.
Shum pulja, pak ve.
Shum njerz e pak fjaljë.
Fjaljët i merr era.
Ndë ng'jan si, jan vesh.
Më mir i shëmtuar se i dekur.
Më mir i dekur se i shëmtuar.
Ësht i bardh ghajdhuri.
Ha sa ke, mos thuaj sa di.
Gruaja qeshën e skungjëdhirën.
Qeshën gruaja e është dos.
Ndëç gruaja qeshën, me vet'hen qeshën.
Qeshën burri e i ka hje.
E di gruaja, e di katundi.

Narratrici: *Concetta Micieli e Guglielma Rossi Micieli, casalinghe di S. Caterina Albanese, con i genitori ambedue albanesi; di 80 anni e analfabeta la prima, di 55 anni e con istruzione elementare la seconda. Data della registrazione: 18.8.1969*

GJAKEGJIZA

Ish nj'jëm e kish nj'bir të vetëm. E jëma i thoj:

- Martohu, biri im!

- E kush m'do mua? - thoj ai i biri.

E e jëma i bëj:

- Martohu! Jam e vetme!

- E jore!

- Martohu, bir!

Dhodu, nj'dit tha:

- Mo, ëm benedhicjonën se vete e gjënj nusen.

U nis e venij. Muari nj'cik buk e nj'cik djath e vej ture ngrënur udh e udh. Dhodu udh e udh preu nj'gjisht e gjaku i vate tek djathi e tha:

- Oj, ruaj si është belu djathi me gjakun!

Dhodu ju përpoq nj'pjak. I tha:

- Ç'ke ç'ruan?

- A, ç'ruanj? Mëma m'tha se ka t'vete e gjënj nusen e u i thash "Ëh!".

Mora nj'cik buk e nj'cik djath e jam e vete ture ngrën. Preva gjishtin e... Ma ruaj si është belu djathi me gjakun! Donja nj'nuse gjakegjiz, kështu e bardh e e kuqe.

- Xa kët mulun!

E ja dha një mulun ai pjak. Ai pjak ish Shën Zepa. I dha mulunin e i tha:

- Xa ktë! Ec te kroj Kuartarun (i thomi na, te nj'krua Kuartarun, ç'është atje ndë strat). Ec te kroj se atje dalnjën tre fata e duan uj. Ndëç ti gjënde e i jep uj te nj'mulun - tha -, të qëndron nj'fat nga ata e e merr për nuse. Njëmos...Tre dit vinjën një për një.

Ai vate nj'dit, duali nj'fat:

- Ëm uj! - tha nj'fat nga ata.

Njera ç'preu mulunin, iku.

- Ëh - tha -, ma pra vjen nj'etër dit.

Vate tek jetra dit pameta versu mjezdit. Duali një fat, tha:

- Ëm uj!

Pameta njera ç'preu mulunin, muari e iku. Dhodu vate tek e treta dit.

Ai muari e e preu më par. Tha:

- Nani e pres më par se hera mulunin, se kështu, kur vjen, ja jap.

Alura daveru kështu bëri. Sa vate ajo:

- Ëm uj!

- Xa! - tha ai.

Ja dha e i qëndroi një fat nga ata e bukur e ç'ish Gjakegjiz, e bardh e e kuqe. Alura, dhopu ç'u vjet ajo i tha:

- Nani pundar ktu. Pundar, se vete e marr letikën. Njëmos si thojën gjindja, se e sial mbë këmb Gjakegjizën?

E u pundar ajo. Alura tek ai krua vejën gjith e mbjojën, mirrjën uj. Sa t'mos t'i thojën gjith gjindet "Ç'je e bën ati? Ç'je e bën ati?", ajo muari e vate e u vu tek nj'arvuri pjanxhende, tek një sheljqe, e u hip atje. Prit, prit, prit. Dhopu vate nj'grua çë srritej cia Ndone, nj'çote, nj'serve. Vate t'ljaj lanxheljet. Ture ljajtur lanxheljet te kroi, shihej te marjana ujit e tha:

- Ru', jam më e bukur u se ata e kam vete te kroy!

Çajti lanxheljet e muari e iku. Vate tek patruni e i tha:

- M'u ça lanxhelja.

I tha ahierna patruni:

- Mirr nj'ashonje, një gharrafun.

Muari gharrafunin pameta e e çajti. Dhopu ng'kishën me ç'e drëgojën e e drëguan me nj'rricul, nj'otër, t'mirr uj. Ma ajo pameta shihej atje e shihej e bukur e thoj:

- Jam më e bukur u se ata e m'drëgonjën te kroy!

Muari at otër, muari me nj'gijlpër e e bëri gjith vëra vëra e i dilj ujt. Ajo Gjakegjiza u v'u sa t'qeshij sipër tek arvuri pjanxhende, tek sheljqa. U vu sa t'qeshij. Kjo pjaka, cia Ndon'ja, e pa e tha:

- Te', u nëng qesha e kjo qeshi!

Ruajti ljart e tha:

- Ti je ati?

- Ëh, tha ajo.

Vate e u hip atje sipër ndë sheljqe se duaj par morrat (më par kishën morra, nani ng'ka morra). Ajo pjaka ish e brut, pjot me dregza, pjot me..., ish languruze, ma duaj par morrat nga ajo vashëz e bukur, kjo cia Ndon'ja. Alura muari nj'spingul e ja ngulji ndë kocht vashzës e e vrau. Muari ahierna ajo nuse, Gjakegjiza, u bë palumb e vularti. Vularti e iku.

Arrvoi dhëndrri me letikën e kumbanjamendin e gjeti atje ndë sheljqe at serv, at pjak e brut. Tha pjaka:

- Erdhe?

- E pse u bëre kështu?

- A, ti m'vure këtu, dieli i ditës e sireni i natës më bën ndë kët maner e zez - tha -, më bën kështu e brut.

Alura rrij qetu ai, e vu mbë letik e e suali mbrënda. Dhopu nënd muaj i

parturirti kjo pjaka e bëri një bilj e kjo palumb i vej tek finestra e t'shoqit e thoj:

- Oj ti ç'bën të ngrënt, çë bën jot shoqe?

Ai nëng ljëngonij faregjë. Dhopu ajo cia Ndone u vu a mende se ish ai palumb se ç'vularti nga sipër t'arvurit t'sheljqes e i tha njëj pjakarelje (se ish njëj pjakarelje ç'e asistirij), i tha:

- Vritn'je, vritn'je kët palumb, se ng'mund e gjegjinj sembri kët mister se ç'bën.

Vate i shoqi e e vrau at palumb, ma i shoqi ng'e dij se ish ajo nusja e bukur. E vrau e asaj pjakarelje i nditi keq sa t'shtij ata gjak jasht e e shtu te ghrasta me ljulje, te ghrasta me gharofulj. Tek ajo ghrast u lje njëj rrëz mulun e nxuari tre mulun'jelje t'boçka kështu e ajo pjakarelje e muari një mulun nga ata e e suali mbrënda te shpia e saj . Ish e fatarme kjo, jo? Dhopu atë ç'hajën mbrënda tek ai burr e gjëjën mbrënda pameta; atë ç'hajën vej mbrënda e gjëjën triesën e paruar me gjith shurbiset, me gjith cikat e mikat, e shpin e pulixjartur. Ru' njëj her e di her e ja tha patrunit:

- Oj patruni im - tha -, ng'e di se ç'ë te shpia ime? Vete mbrënda, ç'hami ktu e gjënj mbrënda, e gjënj shpin e pulixjartur, gjënj shtratin e shtruar e gjënj gjith shorshit t'rixhistrartura.

Tha:

- A! Ti merr e sial mbrënda e kështu thua se e gjënj mbrënda!

- Ma jore se...

- Alura shehu! Shehu atje e shih kush është!

Ajo bëri skosta se dilij e u vu prapa derës. Sa ish versu dhjet o njëmbëdhjet, gjegji strushin nga sënduqi se ajo, muluni, u kish vën mbrënda ndë sënduq. Hapej muluni e dilj njëj rrëmb e bukur, Gjakegjiza. Përveshej, vëhej e i bëj t'ngrënt, i shtronij shtratin e dhopu mirr njëj bikier me uj e e pij e njëj thelj me buk e vej e ulje pameta mbrënda te muluni. Mbulihej muluni, mbulihej sënduqi e rrij atje mbrënda. Kur e pa ajo pjaka dhi sta manera, vate te patruni e i tha:

- Oj patruni im, o m'vret o m'pjek: kështu vete diskursi. Ng'pe se vij ai palumb e ti e vrave? E u gjakun, ndë si çë ngë m'përqueu t'shtinja gjakun, e vura te ghrastat me ljulje, e atje u bëtën mulunet. U e mora një mulun, një nga ata, e e sola mbrënda. Nani nga ai mulun delj njëj grua e bukur, njëj grua e bukur çë ng'ka si t'ruajtur ç'është e bukur.

- Menat vinj t'e shoh u - tha ai patruni.

Alura, më tardu, sa ish l'orarju, vate ai patruni. Vate e u sheh e sa pa se duali nga ai muluni e njohu se ish ajo grua, Gjakegjiza, ç'kish gjetur te kroj Kuartarun e tha:

- Oj!

Dhodu sa muari theljen me buk e bikerin me uj sa t'e pij, sa t'vej mbrënda ndë mulun, i tha:

- Jo, pundaru!

- E pse? Ç' do ti nga u? Ti ke cia Ndonen për shoqe. Ti ghuidhirën me cia Ndonen e u ghuidhirinj si m'e dha Krishti - tha ajo.

- E pse je kështu? - i tha ai.

Muari e i kundarti lu fatu:

- Vij te kroj e l'aj lanxheljet. U ng'dija se kjo çajti atë, çajti atë. Dhodu kur suali otrën e e bëri gjith vëra vëra, u vura t'qeshnja. E ajo duaj par morrat nga u e u i vritnja morrat cia Ndone, ç'ish një languruze me dregza. Ajo muari nj'spingull e m'e ngulji ndë koct e m'vrau. U mora e u bëra palumb e ika, e ti ke cia Ndonen për shoqe.

- E alura ti cia Ndonen si e do? - tha ai.

- E, si e donja? Me nj'kmish pixhje e djegur ndë qac.

E muari a braçu ai Gjakegjizën e van tek e shoqja. Kur e shoqja, cia Ndone, e pa kët grua e veshur e bukur:

- Ojme - tha -, nganu për mua! - se ajo puru e njohu se ish ajo grua e bukur ndë ashojne.

Atë, cia Ndonen, e vun e e dogjtën ndë qac me kmishën me pixh. Ata u ghuidhirtën e ghuidhiren paçe e beni e Shighapitën e shquari qeni.

Narratrice: Agata Raico - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 64 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 18.8.1969

DHIA ME SHTAT KACIQE

Ish nj' dhi ç'kish shtat kaciqe e nj' dit kish t'vej e gjëj nj' cik bar frisku, kjo e jëma. Kaciqravet i tha:

- Ju rrini mbrënda, mos diljni, se mund vinj uljku e ju ha!

- Jore! - kta.

Dhopu vate uljku e busarti e tha:

- Hapni se jam mëma kapra!

- Jo, se ti je uljku! - than. - E shomi ndëç ke këmbët e bardha, këmbët se si i ka mëma!

E ki, uljku, bin e pan këmbët e i kish t'zeza. Than:

- Jo, jo, je uljku e ngë t'duami, se je uljku e ti na ha.

Ai vate ndë muli, vate ngulji ata këmbët ndë miel e vate pameta e tha:

- Hapni se erdha! Jam mëma kapra!

Bustoi këmbët e se ish mëma kapra e hiri. Alura i vikrri, i voglji krapjet vate sa t'shehej prapa tek l'armarju. Ata t'boçkat i muari e i hëngri gjith uljku e dhopu duali e vate jasht ashtu ndë dial sa t'fjëj, se ish i ndëndur. Vate mëma kapra e e gjeti atë t'vikrrin, mënjëlunin e vikërr, e ki i tha:

- Ej', ec! Erdhi uljku e i hëngri e u u trëmba e u sheha e ngë m'hëngri. Ai uljku është atje, fjë ndë dial.

Vate alura e jëma, muari gërshërën, gjilpërën e nj'cik fil, vate jasht, i pjasi pjënsën uljku, bin e i dualtën kaciqrat e e qepi pameta. Mbrënda i vu gurt sa t'bëhej me pjënsën e pjot. Kaciqrat dualtën e ndënjtën me t'jëmën.

Narratrice: *Pasqualina Cristiano* - Paese: *S. Caterina Albanese* - Età: *7 anni* - Istruzione: *II elementare* - Genitori: *ambidue albanesi* - Professione: *scolaro* - Data della registrazione: *18.8.1969*

RINULJENA E JUNUVALJI

Nj'her e nj'her ish nj'vashëz e bukur. Nj'trim, si bëri e si tha, drëgoi e u martua. Kta t'di edhe patën nj'bilj, kish pritjën nj'bilj. Nj'etër trim thoj:

- E, ç'furtun çë pati, çë xhoj vashëz ç'muari! Ndëç u e gjënja një ashtu si ajo e jëma...

Kapirti se kjo vasha pundarij një bilj e e priti. Priti ç'u lje vashëza. Priti njera ç'u rrit e drëgoi për kushqi te kjo vashëz. Atij e jëma i tha:

- Jo! Vasha është e vogljëz.

Priti pak e priti shum, priti njera nënd vjet. Dhopu drëgoi iljzit për kushqi. Ai i jati i tha:

- Jo! Ma ti ç'do? Ç'vete ture gjetur? Ti je i madh, ime bilj u lje dje. U si t'e jap?

Priti pak e priti shum, priti njera nënd vjet. Pameta drëgoi hënzën për kushqi. Ki i vulau i tha:

- Jo! Vasha është e vogljëz e na ng'mund t'e japmi, se e mbami për ne, është vet kjo e na ng'mund t'e japmi kët vashëz si thua ti.

Dhopu ki u nis e vate vet. Gjeti t'jëmën e i tha:

- O, m'e jep o ti ç'thua? Se nj'mos e marr u vet!

E ata do t'ja jipjën o me t'mir o me t'shtrëmbur. E ja dhan. E muari ki e u martuan e u deshtën mir e patën bilj.

Ma dhopu ca vjet ki burr, ç'i thojën Junuvalj, vate ndë ghuerr. Vate ndë ghuerr me Turqit e alura muari t'veshurat e kuqe, muari shpatëzën qarute, muari kaljëthin e brimëz, u puthtën me t'jëmën, me t'shoqen e t'biljt, u ngaljua e vate ndë ghuerr.

Kjo e shoqja priti, priti, priti. U fërrnua ghuerra, ma ki ng'u turtnar. Kjo penxoi se kish dekur, se e kish bjerrur t'shoqin ndë ghuerr e u vu e qaj.

Nj'dit vate e laj kjo ndë ljum, ljaj e qaj. U ndodh sa t'shkoj nj'trim atejna. I tha ki trimi:

- Vash, m'e ljan kët skamandil?

Ajo nëng do t'ja ljaj. Ai thoj:

- Ljajme, ljajme! Ljajme e zbardhëme si bora!

Vate ajo e tha:

- E t'e ljanj si shkuma dejtut, t'e bënj t'bardh si shkuma dejtut.

Pameta ai i tha ksaj vashëz:

- Vash, m'e jep një pikëz uj?

Ajo ng'do t'ja jipij se e kish bjerrur t'shoqin e ng'do t'ja jipij. Ai nxistirti e i tha:

- Ëme, ëme! Ëme nj'cik uj, se nëng bën gjë!
- Jore, jo, nëng mund t'e jap, se kam gjishtrat pjot me uneze! E at pik se çë të mbanj, ka t'ja ljenja burrit t'par, burrit t'im.

Ai pameta nxistirti:

- Çë sinjal kish it zot?

- Kish të veshurën e kuqe.

Ajo shërtoi se nëng e doj kujtuar e ai pameta nxistirti:

- Çë sinjal kish it zot?

- Kishë shpatëzën qarute. Ma u kta shërbise ng'do t'i thom. U ng'kam paçenxje t'i thom, se u ka t'ljanj. Mëma m'pret mbrënda, kam biljt, bora t'im shoq, e u do t'di kta çë m'thua ti?

- Ma thuajmi e mos u ngarika. Çë sinjal kish it zot?

- Kishë kaljëthin e brimëz.

E ai pameta nxistirti përçë ai e kish njohur:

- Thuajm, vash, se si t'e thon!

- Mua m'e thon Rinuljen!

E ai mbeti qetu. Dhopu penxarti nj'cik e tha:

- T'veshurit mua m'u gris, shpatëza mua m'u pjas, kalji mua m'u spovis.

Pameta i tha:

- Thuajmë, vashëz, si t'e thon!

- Mua m'e thon Rinuljen!

- Mua m'e thon Junuvalj, se u itë shoqë jam!

Ai e kish njohur se ish ajo e shoqja, ma ajo ng'e kish njohur se ish ai i shoqi. Alura bit e njohu se ish i shoqi e u puthtën e u muartën e van mbrënda tek e jëma e tek t'biljt, u mbracartën e bëtën fest e gjithsej.

Narratrice: *Guglielma Rossi Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 55 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 16.8.1969*

KOSTANDINI I VOGËLJITH

Ish nj' mëm ç'kish nj'bir, ktëna kish t'e martoj. Dhopu i duali suljdati e pat vej suljdat ki bir. Alura lja kushqin, lja nusen e tha:

- Pritmë!

Ahierna pundarshën njera tet vjet matërmonet. Tha:

- Ndëç shkonjën tet vjet e tet muaj e tet dit, ndëç u ng'erdha, ti martohet, se u ng'vinj më.

Alura, kumbinacjon!, kur ai kish t'vij, drëguan për kushqi tek ajo nuse e ajo tha:

- Dhopu ç' ai m' tha kështu, nani shkoi lu t'embu, u martohemi.

E menatet u di dita, kish t'vejën ndë qish sa t'martohshën, t'vejën kuror. Alura van jetrit bilj tek e jëma:

- Oj mëm! - than.

- Ç' është? - tha.

- Sot martohet jotë re, nusja e Kostandinit.

E jëma, kur gjegji ashtu se i biri nëng kish ardhur, thot:

- Im bir diq poka e është ime re ç'martohet.

U ngre se kish t'vej t'shuljarej. Udh e udh ju përpoq i biri, Kostandini, ç'ish e vij nga suljdati. Ai e njohu t'jëmën, ma e jëma ng'e kish njohur t'birin. Tha:

- Ku vete ti, zonja mëm?

- Vete më shuljariem. Sot martohet ime re, nusja e Kostandinit.

- Priru prapa, zonja mëm, se jam u Kostandini!

Ajo, kur gjegji ashtu, tha:

- Ma jot shoqe është e martohet, nusja jote është e martohet.

- Mos u ngarrikar, mëm, se vete u njëj kredi.

- Vate nd'qish të vëj kuror!

Ai, Kostandini, i rrispundirti:

- Jo, nani vete u ndë qish. Jam u i pari e u ka t'e marr!

Alura vate nd'qish ç'ish e fuljartur me njerz ç'kishën vatur ndë matërmon. Sa hiri te dera e qishës tha:

- Bëni larghë, ju buljar, se jam u kurora e par!

Vate nd'autar tek nusja, nxuari at dhëndërr ç'kish vatur më dhopu e e martoi ai e e vinxhirti nusen.

Narratrice: *Cristina Pisarri - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 87 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 27.8.1967*

PROVERBI - FJALJË ARI

Një ç'bën keq, keq gjën.
Shkon nata, vjen dita.
Më ka e më do.
Më shum vret grika se shpata.
Buk e hi, ma ndë shpi.
I ka bijtur dhëmbi i xhudhixit.
Turres bën turres.

Narratrici: *Guglielma Rossi Micieli - Paese S. Caterina Albanese - Età: 55 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 16.9.1969*

Concetta Micieli - Paese: S. Caterina Albanese - Età: 80 anni - Istruzione: analfabeta - Genitori: ambedue albanesi - Professione: casalinga - Data della registrazione: 17.8.1969



“Vallet” Picili në vitet '60.
Le “Valle” a S. Caterina Albanese negli anni '60.

Italiano

L'UCCELLO CHE CANTA IN MEZZO ALLA CASA

Una volta c'erano due ragazze. C'erano due ragazze, due sorelle, ed avevano un fratello (in quel tempo non era come oggi che si vive nell'agiatazza; in quei tempi si penava anche per avere uno sterpo) e, non avendo dove andare a raccogliere sterpi, salirono sulla montagna del re. Allora disse la prima sorella:

- Eh, io non ha avuto fortuna, ma se mi amasse il guardiano del re, io lo sposerei.

Il guardiano del re la sentì, poiché era nel bosco dove pascolava i buoi e altri animali e faceva molti altri lavori; la sentì, ma stava zitto. La seconda sorella disse:

- Sì, io vorrei avere il figlio del re per sposo. Ma gli farei avere una bella cosa che voi non potete crederci: se avessi da lui due figli, uno glielo farei con una stella d'oro in fronte e l'altro con una palla d'oro nella mano...

Di nuovo sentì il guardiano. Andò e lo raccontò al re.

Il re allora mandò a chiamare le due ragazze. Chiese:

- Che cosa avete detto nel bosco?

- Proprio niente!

- No, ditemelo, se no vi taglio la testa!

- Ma sai, non lo possiamo dire.

- No, dovete dirmelo per forza, se no io comando di farvi tagliare la testa.

Dovettero dirlo. Disse la prima:

- Io prenderei il guardiano per sposo.

La seconda non voleva dirlo poiché si vergognava del re, ma fu costretta a dirglielo.

Il re disse:

- Sì che ve li faccio sposare. Tu e tu... tu e tu... Però dovete mantenere la parola, se no vi faccio tagliare la testa. E zitte!

Fu veramente così. La prima sorella sposò il guardiano del re. La seconda sposò il principe, il figlio del re. Ma la madre, la moglie del re, non voleva che il principe sposasse questa ragazza. Non la voleva.

- Tu vai a sposare una tale ragazza? Una ragazza povera?

Ma il principe la sposò ugualmente. Loro due erano contenti e si volevano bene. Dopo un po' di tempo scoppiò la guerra ed il principe dovette partire per la guerra. Ma tutti i pensieri erano rivolti alla moglie, poiché si rendeva conto che la madre non le voleva bene.

La moglie mantenne la parola e dopo un po' di tempo partorì quei due bambini, uno con la stella d'oro in fronte e l'altro con una palla d'oro nella mano. Ma la nonna, cioè la madre del principe, non li voleva, fu senza coscienza e portò i due bambini al mulino e li buttò là. Il mugnaio, quando la mattina arrivò, li trovò e li portò a sua moglie.

- Guarda che bei bambini! Tagliare la testa a questi due bambini? E' peccato! No?

La moglie del mugnaio crebbe quei due bambini coi suoi figli. Giocavano insieme e si volevano bene.

Intanto la moglie del principe, quella ragazza, cioè la madre dei due bambini, la maltrattavano, la sotterrarono completamente, la rinchiusero nel pollaio e le davano una fetta di pane ed un bicchiere d'acqua al giorno.

I due bambini andavano d'accordo coi figli del mugnaio finché non crebbero; poi cominciarono a litigare con loro e dissero al padre, al mugnaio:

- Noi andiamo via, noi andiamo via, se no litighiamo tra noi.

- Ma no! Io vi ho cresciuti, rimanete, rimanete!

- No, noi andiamo via. Tu mantieni i tuoi figli, noi invece andiamo in cerca della nostra fortuna.

Allora il padre diede loro la benedizione ed andarono via. Dopo un po' di cammino, incontrarono un vecchierello che chiese:

- Dove andate, figliuoli, dove andate?

- Dove andiamo? Andiamo in cerca della nostra fortuna, ché ci è morta la mamma (loro sapevano così, che la madre era morta). La mamma è morta ed andiamo dove ci porta il vento, andiamo dove ci danno un po' di pane, capisci?

Disse il vecchio:

- Volete andare davvero dove potete avere il pane? Camminate, camminate, camminate molto, camminate verso quel monte perché là troverete un palazzo con dentro tutto il ben di Dio. Quello che troverete, accomodatevi e mangiatelo.

Andarono e arrivarono a quel palazzo e davvero trovarono la tavola ben apparecchiata e s'accomodarono e mangiarono.

Il figlio del re, quando finì la guerra, tornò a casa.

Tornò dalla guerra a casa e la madre gli disse:

- Ah, era cosa da impazzire, io non sapevo che cosa fare... Guarda che tradimento ti ha fatto tua moglie: aveva detto che ti avrebbe partorito due bambini, uno con la stella in fronte e l'altro con una palla nella mano, invece partorì due cagnolini... Eh, non era possibile che vivessi con lei...

Non aprì bocca quel poverino.

Un giorno andò a caccia con un compare. Cammina cammina, arrivano a quel palazzo, vide quei due bambini e chiese:

- Che cosa fate voi qui?

- Ci condusse un vecchierello qui. Ci mandò un vecchierello, e perciò ci troviamo qui.

- Sì, è vero, avete tutto, ma vi manca una cosa.

- No, non ci manca niente - risposero al re, cioè al principe - Va' via! Va' dove devi andare, ché noi non conosciamo nessuno.

Tornò a casa il principe e raccontò alla madre:

- Madre mia, - le disse - voi non sapete che sul monte ho trovato un palazzo dove c'erano due bambini proprio come li doveva partorire mia moglie: con la stella in fronte e la palla d'oro nella mano...

La madre gli rispose:

- Va' via, va' via, tua moglie partorì due cagnolini... Va' dove devi andare! Va' a mangiare se vuoi mangiare! Va' a dormire!

Lui tutto irritato andò a dormire. La madre intanto mandò il servitore, quello che lavava le posate e che preparava il cibo, lo mandò là dicendogli:

- Guarda che è andato sulla montagna mio figlio e potrà capitarci qualche disgrazia, perché questi ora o stasera o domani saprà che sono i suoi figli.

Allora partì il servitore ed andò a raggiungerli (il fratello della ragazza intanto era uscito, non era in casa) e disse alla ragazza:

- Senti cosa ti dico: avete tutto qui, ma vi manca una cosa.

- Che cosa ci manca?

- Vi manca l'acqua della felicità.

- L'acqua della felicità?

- Sì, sì, l'acqua della felicità.

- Come possiamo fare a trovarla?

- Ah, - disse - stasera fa' che tuo fratello ti trovi di cattivo umore, poiché lui andrà a cercartela.

Tornò a casa il fratello e trovò la sorella di cattivo umore, piangeva. Aveva preparato il cibo e non voleva mangiare.

Le disse:

- Ma cos'hai stasera che stai così?

- Ah, guarda - disse - come siamo: abbiamo tanti beni che ci mandò Gesù Cristo, però non siamo felici, ché ci manca l'acqua della felicità per poter lavarmi...

- Ah, - disse - per questo tu non devi addolorarti, ché io vado a trovar-

ti l'acqua. Stasera parto e se domani sera alle quattro non ritorno, tu chiudi la porta, chiudi le finestre, chiudi tutto, poiché vuol dire che non son potuto ritornare.

- E allora non andare! - disse al fratello.

- Eh, ormai me l'hai detto e ci vado.

E andò. Andò e di nuovo, appena arrivato alla montagna, trovò quel vecchierello che gli disse:

- Dove vai tu, gioia?

Gli rispose il ragazzo:

- Dove vado? Vado a ... abbiamo tutto, ma ci manca l'acqua della felicità perché si lavi mia sorella.

- E chi ti ha mandato?

- Mia sorella. La trovai di cattivo umore e adesso le devo trovare l'acqua, se no rimarrà addolorata.

Allora gli disse il vecchio:

- Cammina dritto, ché là c'è una piccola sorgente. Là c'è una vecchia che vorrà riempire il fosso d'acqua prima di te. Ma tu non lasciarglielo riempire prima, lo riempi tu, se no muori.

- No, non preoccuparti! - gli rispose.

